



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2015 – Numri: 117

Tiranë – E mërkurë, 8 korrik 2015

PËRMBAJTJA

	Faqe
Dekret i Presidentit nr. 9151, datë 29.6.2015	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 6147
Udhëzim i përbashkët i ministrit të Punëve të Brendshme dhe ministrit të Financave nr. 345, datë 24.6.2015	Për masën, kriteret dhe procedurat për tarifat financiare për veprimtarinë e shërbimit privat të sigurisë fizike..... 6147
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 43, datë 26.6.2015	Me objekt shpalljen si të papajtueshme me Kushtetutën, të kreut VI, “Byroja Kombëtare e Hetimit” (nenet 27-36) dhe nenit 49 të ligjit nr. 108, datë 31.7.2014, “Për Policinë e Shtetit”..... 6149
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 44, datë 29.6.2015	Me objekt shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimit nr. 00-2014-2555, datë 1.10.2014, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë..... 6165
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 45, datë 29.6.2015	Me objekt shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, të vendimeve nr. 00-2013-1026, datë 10.5.2013 të Gjykatës së Lartë dhe nr. 1446, datë 20.6.2011, të Gjykatës së Apelit Tiranë..... 6169
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 46, datë 29.6.2015	Me objekt shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të nenit 2, të ligjit nr. 100/2014 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”..... 6174
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 80, datë 30.6.2015	Për fillimin e procedurave për shqyrtimin dhe miratimin e rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të pjesshëm ose të plotë, rinovimit dhe heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike..... 6182
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 81, datë 30.6.2015	Për fillimin e procedurave për miratimin e rregullores mbi procedurat për certifikimin e operatorit të sistemit të transmetimit të energjisë elektrike..... 6183

Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 82, datë 30.6.2015	Për fillimin e procedurave për shqyrtimin dhe miratimin e rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s.....	6183
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 83, datë 30.6.2015	Për licencimin e shoqërisë “Gama Energy” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et “Lena 1” me fuqi të instaluar 1.95 MW, “Lena 2” me fuqi të instaluar 2.3 MW dhe “Lena 2a”; me fuqi të instaluar 0.25 MW (me fuqi totale 4.5 MW).....	6183
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 84, datë 30.6.2015	Për fillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë “Lengarica & Energy” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Lengarica”, me fuqi të instaluar 8.94 MW.....	6184
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 85, datë 30.6.2015	Për fillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë “Lengarica & Energy” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.....	6185
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr 86, datë 30.6.2015	Për fillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë “Lengarica & Energy” sh.p.k., në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike.....	6185
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 87, datë 30.6.2015	Për refuzimin e kërkesës për licencimin e shoqërisë “Phoenix Petroleum” sh.a., në aktivitetin e tregtimit të gazit natyror.....	6186
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 88, datë 30.6.2015	Për fillimin e procedurave për miratimin e një ndryshimi në rregullat e tregut shqiptar të energjisë elektrike.....	6187

**DEKRET****Nr. 9151, datë 29.6.2015****PËR LEJIMIN E LËNIES SË
SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c” dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe të neneve 15 e 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998, “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar edhe në propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:**Neni 1**

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Migena Faik Dharmo (Miraçi)
2. Etleva Nuri Veisllari
3. Besmir Ismet Kajolli
4. Redion Ismet Kajolli
5. Aida Bedri Meti (Patoku)
6. Sabine Viktor Belçaku
7. Sarah Viktor Belçaku
8. Jonna (Fatjona) Idriz Kuball (Hoxhaj)
9. Haki Azis Merko
10. Xhovalin Zaim Jakupi
11. Jona Xhovalin Jakupi
12. Ilir Hysenj Spec
13. Mariglana Mexhit Mitrushi (Gjyla)
14. Elda Ferit Karaj
15. Polikron Astrit Memlika
16. Odeta Safet Ittenbach (Shuti)
17. Rroki Arben Ndreka
18. Kleitia Vergjil Monari
19. Elona Hysmet Lulo
20. Adile Beqir Muka
21. Endrit Llesh Ndoj
22. Devi Llesh Ndoj
23. Hatixhe Ramadan Lila (Hoxha)
24. Klodjan Gurtali Lila
25. Mentor Osman Osmanaj
26. Jetlir Lutfi Kolaneci
27. Silva Eduard Agostini

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

**PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË
Bujar Nishani**

UDHËZIM I PËRBASHKËT**Nr. 345, datë 24.6.2015****PËR MASËN, KRITERET DHE
PROCEDURAT PËR TARIFAT
FINANCIARE PËR VEPRIMTARINË E
SHËRBIMIT PRIVAT TË SIGURISË
FIZIKE**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, pikës 4, të nenit 48, të ligjit nr. 75/2014, “Për shërbimin privat të sigurisë fizike”, ligjit 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, si dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 432, datë 28.6.2006, “Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave që krijojnë institucionet buxhetore”, ministri i Punëve të Brendshme dhe ministri i Financave,

UDHËZOJNË:

1. Miratimin e tarifave për veprimtarinë e shërbimit privat të sigurisë fizike në zbatim të ligjit nr. 75/2014, “Për shërbimin privat të sigurisë fizike”, si më poshtë:

1.1 Tarifë për pajisjen me licencë, subjektit për shërbimin privat të sigurisë fizike, nënkategoria 1.3. A, SHPSF, 150 000 lekë.

1.2 Tarifë për pajisjen me licencë, subjektit për shërbimin privat të sigurisë fizike, nënkategoria 1.3. B, SHPSF, 150 000 lekë.

1.3 Tarifë për pajisjen me certifikatë për titullarë subjekti SHPSF, 45 000 lekë.

1.4 Tarifë për pajisjen me certifikatë për drejtues teknik subjekti SHPSF, 45 000 lekë.

1.5 Tarifë për pajisjen me certifikatë për punonjës SHPSF, 2 000 lekë.

1.6 Tarifë për pajisjen me licencë për kurs trajnimi privat të punonjësve të SHPSF-ve, 200 000 lekë.

1.7 Tarifë për kurs trajnimi për pajisjen me dëshmi në institucionin arsimor policor për kandidatë për punonjës që do të punësohen në subjektet SHPSF, pa akomodim (në ditë), 2 500 lekë.

1.8 Tarifë për pajisjen me autorizim për mjete të blinduara për personat fizikë, 300 000 lekë.

1.9 Tarifë për pajisjen me autorizim për mjete të blinduara për SHPSF-në, 100 000 lekë.



1.10 Tarifë për pajisjen me autorizim për mbajtjen e mjeteve speciale për subjektet që ushtrojnë veprimtari për SHPSF-në, 200 lekë.

2. Të ardhurat që realizohen nga shërbimet që ofrohen nga policia në zbatim të ligjit, “Për shërbimin privat të sigurisë fizike” do të trajtohen si të ardhura nga veprimtaria kryesore të cilat realizohen nga institucioni buxhetor, gjatë kryerjes së detyrave të tyre funksionale. Këto të ardhura derdhen tërësisht në buxhetin e shtetit dhe shpenzohen si pjesë e totalit të të ardhurave të këtij buxheti.

3. Tarifat e pagesës, të detajuara për çdo lloj shërbimi, që kryhen ndaj personave juridikë e fizikë, publikë ose privatë, përcaktohen sipas këtij udhëzimi dhe tabelës nr. 1.

4. Tarifa e përcaktuar në pikat 1.3, 1.4 dhe 1.5 të këtij udhëzimi për ripërtëritjen e certifikatës së

titullarit, drejtuesit teknik dhe punonjësit të SHPSF-së, bëhet me 50% më pak të vlerës së pajisjes.

5. Me këtë udhëzim të njihen të gjithë punonjësit e policisë, si dhe personat e interesuar për aktivitetin e veprimtarisë së shërbimit privat të sigurisë fizike.

6. Me zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen strukturat e Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe strukturat e Ministrisë së Financave.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËVE TË BRENDSHME
Saimir Tahiri

MINISTRI I FINANCEVE
Shkëlqim Cani

TABELA NR. 1

TARIFAT E SHËRBIMEVE TE POLICISË SE SHTETIT NDAJ TE TRETËVE PAR SHPSF

Nr.	Emërtimi te ardhurave	Tarifa		Afati	
		Aktuale	Për miratim	Ishte	Behet
1	Tarifë për pajisjen me licence, subjektit për shërbimin privat të sigurisë fizike, nënkategoria 1.3.A, SHPSF.	45 000	150 000	3-vjeçare	E përhershëm
2	Tarifë për pajisjen me licence, subjektit për shërbimin privat të sigurisë fizike, nënkategoria 1.3.B, SHPSF.	45 000	150 000	3-vjeçare	E përhershëm
3	Tarifë për pajisjen me certifikatë për Titullarë Subjekti SHPSF	45 000	45 000	3-vjeçare	4-vjeçare
4	Tarifë për pajisjen me certifikatë për Drejtues Teknik Subjekti SHPSF.	45 000	45 000	3-vjeçare	4-vjeçare
5	Tarifë për pajisjen me certifikatë për punonjës SHPSF	1 000	2 000	E përhershme	4-vjeçare
6	Tarifë për pajisjen me licence për kurs trajnimi privat të punonjësve të SHPSF-ve.	E re	200 000	E re	4-vjeçare
7	Tarifë për kurs trajnimi për pajisjen me dëshmi në institucionin arsimor policor për candidate për punonjës që do të punësohen në subjektet SHPSF, pa akomodim (në ditë).	E re	2 500	E re	Pa afat
8	Tarifë për pajisjen me autorizim për mjete të blinduara për personat fizik.	0	300 000	E Përhershme	E Përhershëm
9	Tarifë për pajisjen me autorizim për mjete të blinduara për SHPSF.	0	100 000	1 -vjeçare	1 -vjeçare
10	Tarifë për dhënie autorizim për mbajtje mjete speciale për subjektet që ushtrojnë veprimtari për SHPSF.	0	200	E Përhershme	E Përhershëm



VENDIM

Nr. 43, datë 26.6.2015

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja kryetar i Gjykatës Kushtetuese			
Sokol Berberi	anëtar i	“	“
Vitore Tusha	anëtare e	“	“
Altina Xhoxhaj	anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“
Gani Dizdari	anëtar i	“	“
Besnik Imeraj	anëtar i	“	“
Fatos Lulo	anëtar i	“	“
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“

me sekretare Blerina Basha, në datën 4.3.2015 mori në shqyrtim në seancë plenare me dyer të hapura çështjen me nr. 69/36 Akti, që i përket:

KËRKUES: Një grup deputetësh të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë (jo më pak se një e pesta e deputetëve), përfaqësuar nga zoti Ivi Kaso dhe zoti Gazmend Bardhi, me autorizim.

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga zoti Alban Brati, zonja Mimoza Arbi dhe zoti Geldjon Hysolli, me autorizim.

Këshilli i Ministrave, përfaqësuar nga zoti Sokol Pashko dhe zoti Artur Micko, me autorizim.

OBJEKTI: Shpalljen si të papajtueshëm me Kushtetutën, të kreut VI “Byroja Kombëtare e Hetimit” (nenet 27-36) dhe nenit 49 të ligjit nr. 108, datë 31.7.2014, “Për Policinë e Shtetit”.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 7, 42, 116, 124, 131/a, 134/1/c dhe 148 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Vladimir Kristo; përfaqësuesin e kërkuarit, jo më pak se një e pesta e deputetëve të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, që kërkonte pranimin e kërkesës; përfaqësuesit e subjektit të interesuar, Kuvendit të Republikës së Shqipërisë; përfaqësuesit e Këshillit të Ministrave, që kërkon rrëzimin e kërkesës, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kuvendi i Republikës së Shqipërisë (*në vijim Kuvendi*) në datën 31.7.2014 ka miratuar ligjin nr. 108/2014, “Për Policinë e Shtetit” (*ligji nr. 108/2014*). Ky ligj është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 137, datë 1.9.2014. Sipas nenit 145 të tij, ligji hyn në fuqi 6 muaj pas botimit në Fletoren Zyrtare, pra në datën 1.3.2015.

2. Referuar titullit, objektit të rregullimit të dispozitave, si dhe përmbajtjes së ligjit nr. 108/2014, në thelb, ai ka si qëllim përcaktimin e misionit, organizimin, funksionimin, detyrat, të drejtat dhe statusin e Policisë së Shtetit në Republikën e Shqipërisë, si dhe rregullimin e veprimtarisë, të marrëdhënieve të punës, garantimin e karrierës, të mirëqenies dhe vazhdimësisë në detyrë të punonjësit të Policisë.

II

3. **Kërkuesi, jo më pak se 1/5-ta e deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë**, në datën 9.10.2014 i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) me kërkesë për shfuqizimin e neneve 27-36 dhe 49 të ligjit nr. 108/2014 si antikushtetuese. Në mënyrë të përmbledhur kërkuesi ka parashtruar:

3.1 Për sa i përket legjitimitimit në paraqitjen e kërkesës për shfuqizimin si antikushtetuese të neneve të lartpërmendura të ligjit nr. 108/2014, plotësohet kriteri numerik i parashikuar nga neni 134, pika 1, shkronja “c”, sipas të cilit “*Gjykata vihet në lëvizje vetëm me kërkesë të [...] jo më pak se një së pestës së deputetëve*”. Po ashtu, sipas kërkuarit, grupi i deputetëve plotëson edhe kriterin tjetër që ka të bëjë me pasjen e qëllimit dhe të nxitjes konkrete për të kërkuar kontrollin abstrakt të normës, e cila buron nga e drejta e pakicës parlamentare për të kërkuar mbrojtjen e parimit të shtetit të së drejtës e të parimit të ndarjes dhe balancimit të pushteteve, si dhe respektimin e përgjegjësisë kushtetuese të institucioneve të pavarura.

3.2 Lidhur me themelin e kërkesës, ligji objekt kundërshtimi në pjesën ku parashikon krijimin dhe kompetencat e Byrosë Kombëtare të Hetimit, bie ndesh me nenin 148 të Kushtetutës, pasi përcakton mbivendosje të kompetencave të kësaj strukture, në varësi të ministrit të



Brendshëm, me ato të organit të Prokurorisë, si i vetmi organ i parashikuar nga Kushtetuta që ushtron ndjekjen penale.

3.3 Ligji, duke i njohur Byrosë Kombëtare të Hetimit të drejtën për të kryer veprime gjurmuese dhe hetimore, nuk parashikon në asnjë dispozitë raportet e varësisë të saj nga organi i Prokurorisë. Heqja e eskuzivitetit organit të Prokurorisë në drejtimin e hetimeve të veprës penale, përbën shmangie të këtij organi nga ushtrimi i veprimtarisë së tij kushtetuese. Në këtë mënyrë cenohet edhe parimi i ndarjes dhe balancimit të pushteteve, i sanksionuar në nenin 7 të Kushtetutës.

3.4 Kompetencat e Byrosë Kombëtare të Hetimit bien ndesh edhe me dispozitat (nenet 30, 277, 293 dhe 304) e Kodit të Procedurës Penale (KPP-së), të cilat përcaktojnë kompetencat e prokurorit në ndjekjen e veprës penale. Për pasojë, përplasjet midis dispozitave të ligjit të kundërshtuar dhe KPP-së, ky i fundit i miratuar me shumicë të cilësuar, nuk respektojnë edhe nenin 116 të Kushtetutës. Në këtë këndvështrim, në respekt të parimit të hierarkisë së akteve normative, ligjet e zakonshme duhet të nxirren jo vetëm në bazë dhe për zbatim të Kushtetutës, por duhet treguar kujdes i veçantë që ato të mos jenë në kundërshtim edhe me ligjet me shumicë të cilësuar.

3.5. Veprimtaria gjurmuese dhe hetimore, që ligji sanksionon të kryhet nga Byroja Kombëtare e Hetimit, cenon të drejtën kushtetuese të çdo individit për një proces të rregullt ligjor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, si dhe nuk respekton parimin e ligjshmërisë.

3.6 Disponimet e nenit 49 të ligjit në fjalë lidhur me rikthimin në strukturat e Policisë së Shtetit, të cilat duke përkeqësuar gjendjen e mëparshme të punonjësit të policisë, cenojnë pozitën e një kategorie të gjerë punonjësish, cenojnë parimin e sigurisë juridike.

4. **Subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave**, së bashku me ministrin e Punëve të Brendshme kanë prapësuar në mënyrë të përmbledhur, se:

4.1 Për pranueshmërinë e kërkesës, në prapësimet me shkrim dërguar kësaj Gjykate para zhvillimit të seancës gjyqësore, subjekti i interesuar ka parashtruar se neni 145 i ligjit të

kundërshtuar përcakton se ligji hyn në fuqi 6 muaj pas botimit në Fletoren Zyrtare. Ligji është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 137, datë 1.9.2014 dhe prandaj hyn në fuqi në datën 1.3.2015. Për pasojë, në momentin e depozitimit të kërkesës rezultonte se ligji nuk kishte hyrë akoma në fuqi. Neni 50 i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese” e lidh të drejtën e subjekteve për të kundërshtuar një ligj në Gjykatën Kushtetuese edhe me momentin e hyrjes në fuqi të tyre. Sipas subjektit të interesuar, përderisa ligji i kundërshtuar nuk ka hyrë ende në fuqi, nuk mund të përbëjë objekt kontrolli kushtetues.

4.2 Për sa i përket themelit të kërkesës, veprimtaria gjurmuese dhe hetimore që do të kryejë Byroja Kombëtare e Hetimit, sipas nenit 27, pika 2, të ligjit nr. 108/2014, është në përputhje me legjislacionin penal dhe procedural penal. Kjo strukturë nuk ka si qëllim të krijojë paralelizma apo të suprimojë veprimtarinë e organit të Prokurorisë dhe Policisë Gjyqësore, por të ndihmojë në luftën kundër korrupsionit. Krijimi i saj është diktuar nga nevojat imediate që ka vendi në parandalimin dhe hetimin e veprave penale në fushën e korrupsionit.

4.3 Ligji nr. 108/2014 ka përcaktuar një raport llogaridhënie të Byrosë Kombëtare të Hetimit para drejtorit të Policisë së Shtetit për veprimtarinë gjurmuese dhe para Prokurorit për veprimtarinë hetimore procedurale. Në këtë mënyrë kontrolli i hetimeve përsëri i mbetet organit të Prokurorisë. Prokuroria mbikëqyr punën e kësaj byroje me anën e kontrollit të hetimit, të formulimit dhe të ngritjes së aktakuzës.

4.4 Në hartimin e ligjit nr. 108/2014 është treguar kujdes i veçantë që ai mos të bjerë ndesh as me ligjet me shumicë të cilësuar, as me ligjet e tjera të thjeshta, duke respektuar nenin 116 të Kushtetutës. Gjithashtu, gjatë fazës së draftimit të tij ligji ka kaluar në një proces të gjatë konsultimi me ministrinë e linjës dhe institucionet e pavarura kushtetuese, përfshirë Prokurorinë.

4.5 Nuk cenohet e drejta për një proces të rregullt ligjor, pasi çdo hetim që do të kryejë Byroja Kombëtare e Hetimit do të jetë i njëjtë me hetimet që kryhen për veprat e tjera penale dhe do t'i nënshtrohet parimit të ligjshmërisë dhe zbatimit të të drejtave të njeriut.



4.6 Parashikimi në ligj i kriterëve të reja për rikthimin në punë të punonjësit të Policisë së Shtetit ka funksion garantues për të shmangur lëvizjet e shumta të personelit, të kushtëzuara nga hyrjet e daljet në Polici. Ai ka si qëllim që rikthimi në punë i këtyre punonjësve të jetë proces i bazuar në kriterë objektive në funksion të garantimit të profesionalizmit dhe respektimit të kriterëve të bazuara në ligj.

5. **Subjekti i interesuar, Kuvendi i Shqipërisë**, ka prapësuar në mënyrë të përmbledhur, se:

5.1 Nenet 27-36 të ligjit nr. 108/2014, që parashikojnë dhe rregullojnë organizimin dhe funksionimin e Byrosë Kombëtare të Hetimit, nuk cenon pavarësinë organizative të organit të Prokurorisë, pasi Byroja funksionon si një strukturë e veçantë e Policisë së Shtetit. Varësia e saj nga ministri i Brendshëm nuk nënkupton varësinë funksionale të saj prej këtij ministri, pasi ajo ka të bëjë vetëm me nxjerrjen e akteve nënligjore përkatëse për funksionimin administrativ dhe aspektin menaxherial të burimeve njerëzore. Byroja Kombëtare e Hetimit nga përmbajtja e kreut VI të ligjit të kundërshtuar rezulton se ka varësi të dyfishtë, në aspektin procedural nga Prokurori dhe për sa i përket organizimit dhe funksionimit të strukturës, nga ministri i Brendshëm.

5.2 Krijimi i Byrosë Kombëtare të Hetimit është diktuar nga nevojat imediate në parandalimin dhe hetimin e veprave penale në fushën e korrupsionit, për shkak të evidentimit të rasteve të shumta të korrupsionit në fushën e gjyqësorit, doganave, tatimeve, policisë, shëndetësisë, arsimit etj. Modeli i kësaj strukture është huazuar nga vende të zhvilluara demokratike, si p.sh., Sllovenia.

5.3 Në aspektin e pavarësisë funksionale të organit të Prokurorisë, Byroja Kombëtare e Hetimit nuk e dublon dhe nuk e zëvendëson atë në ushtrimin e funksionit kushtetues të ndjekjes penale. Roli i Prokurorisë në ushtrimin e këtij funksioni gjendet i pasqyruar edhe në përmbajtjen e nenit 27, pika 2, të ligjit nr. 108/2014, i cili parashikon se veprimtaria gjurmuese dhe hetimore e Byrosë do të jetë në përputhje me legjislacionin penal dhe procedural penal. Pikërisht ky nen përcakton vartësinë procedurale të Byrosë nga organi i Prokurorisë.

Edhe neni 36 i ligjit parashikon se punonjësit e Byrosë kryejnë veprimtarinë e tyre në përputhje me legjislacionin në fuqi.

5.4 Mbledhja dhe grumbullimi i të dhënave, që përbën një nga detyrat e punonjësve të Byrosë Kombëtare të Hetimit, edhe pse cenon aspekte të jetës private, respekton nenet 17 dhe 35 të Kushtetutës, pasi është e parashikuar me ligj dhe kryhet për një interes publik, parandalimi dhe goditja e veprave penale në fushën e korrupsionit.

5.5 Krijimi dhe funksionimi i Byrosë Kombëtare të Hetimit ka të bëjë me efikasitetin e organizimit të Policisë së Shtetit në realizimin dhe përmbushjen e misionit të saj. Ky rregullim ligjor, përderisa nuk shkel parimet kushtetuese, nuk mund të konsiderohet si çështje e juridiksionit kushtetues, pasi bie brenda hapësirës që ka Kuvendi në ushtrimin e funksionit të tij ligjvënës.

5.6 Kufizimi i vendosur në nenin 49, të ligjit nr. 108/2014, nuk cenon parimin e sigurisë juridike, sepse ky kufizim është diktuar nga interesi publik i mbrojtjes së misionit të Policisë së Shtetit, që është ruajtja e rendit dhe sigurisë juridike, çka mund të sigurohet vetëm nëpërmjet garantimit të një policie të aftë.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Mbi legjitimitimin e kërkesës

6. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë në nenin 134/1 ka përcaktuar në mënyrë shteruese rrethin e subjekteve kushtetuese, të cilat legjitimohen të vënë në lëvizje juridiksionin kushtetues. Kriteri kushtetues i “detyrimit për të justifikuar interesin”, i përcaktuar në paragrafin 2 të nenit të mësipërm, është interpretuar nga jurisprudenca kushtetuese si përcaktues në ndarjen e rrethit të subjekteve kushtetuese në dy kategori: subjekte të kushtëzuara dhe subjekte të pakushtëzuara. Në këtë kuptim, subjektet e parashikuara në shkronjat “dh”, “e”, “ë”, “f” dhe “g”, të paragrafit 1, të nenit 134, të cilat mund të bëjnë kërkesë vetëm për çështje që lidhen me interesat e tyre, janë subjekte të kushtëzuara. Parashikimi i këtij kriteri kushtetues vetëm për një numër të kufizuar subjektësh kushtetues, në një interpretim *a contrario*, do të thotë se ai nuk është i zbatueshëm për subjektet e tjera të



parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “c” dhe “ç”, të pikës 1, të nenit 134 të Kushtetutës, të cilat nuk kanë detyrimin për të justifikuar interesin në rast se i drejtohen me kërkesë Gjykatës Kushtetuese.

7. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) të një të pestës së deputetëve ka qenë objekt i shqyrtimit nga kjo Gjykatë edhe në raste të tjera, në të cilat ajo në mënyrë të vazhdueshme ka vlerësuar se një e pesta e deputetëve përfaqëson një nga subjektet e parashikuara në nenin 134/1, shkronja “c”, të Kushtetutës, të cilat kanë të drejtë të vënë në lëvizje juridiksionin kushtetues për arsye të një interesi publik, pa u kushtëzuar me një interes subjektiv konkret (*shih vendimin nr. 9, datë 23.3.2010 të Gjykatës Kushtetuese*). Interesi i këtyre funksionarëve publikë për të mbrojtur sistemin normativ dhe parimet shtetformuese, si: konstitucionalizmi, shteti i së drejtës, demokracia, dinjiteti njerëzor, barazia sociale etj., të shpalosura në Kushtetutë, nuk është i kushtëzuar (*shih vendimin nr. 18, datë 29.7.2008 të Gjykatës Kushtetuese*).

8. Nga sa më sipër, Gjykata në asnjë rast nuk e ka vënë në dyshim legjitimitetin e një të pestës së deputetëve kur ata i janë drejtuar kësaj Gjykate për kontrollin abstrakt të normës juridike. Për pasojë, edhe në rastin në shqyrtim, në referim të nenit 134/1, shkronja “c”, Gjykata çmon se jo më pak se 1/5-ta e deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë përfaqëson një subjekt me legjitimitet të pakushtëzuar dhe si i tillë legjitimohet të kërkojë kontrollin abstrakt të kushtetutshmërisë së një ligji.

B. Për juridiksionin e Gjykatës

9. Gjykata, paraprakisht konstaton se në prapësimet me shkrim, subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave, ka pretenduar mungesën e juridiksionit të Gjykatës pasi ligji i kundërshtuar në momentin e paraqitjes së kërkesës nuk kishte hyrë ende në fuqi. Gjatë seancës gjyqësore, duke qenë se ndërkohë ligji hyri në fuqi, Këshilli i Ministrave hoqi dorë nga ky pretendim. Për pasojë, në vijim, Gjykata do t’u japë përgjigje pretendimeve të palëve mbi themelin e kërkesës.

C. Për cenimin e neneve 4, 7 dhe 148 të Kushtetutës

10. Kërkuesi pretendon se ligji objekt kundërshtimi në pjesën ku parashikon krijimin dhe kompetencat e Byrosë Kombëtare të Hetimit, bie ndesh me nenin 148 të Kushtetutës,

pasi përcakton mbivendosje të kompetencave të kësaj strukture, në varësi të ministrit të Brendshëm, me ato të organit të Prokurorisë, si i vetmi organ i parashikuar nga Kushtetuta që ushtron ndjekjen penale. Gjithashtu, sipas kërkuesit dispozitat e ligjit, duke i njohur Byrosë Kombëtare të Hetimit të drejtën për të kryer veprime gjurmuese dhe hetimore, nuk parashikojnë asnjë varësi të saj nga organi i Prokurorisë. Heqja e ekskluzivitetit organit të Prokurorisë në drejtimin e hetimeve të veprës penale përbën shmangie të këtij organi nga ushtrimi i veprimtarisë së tij kushtetuese. Në këtë mënyrë cenohet edhe parimi i ndarjes dhe balancimit të pushteteve, i sanksionuar në nenin 7 të Kushtetutës.

11. Subjektet e interesuara, Këshilli i Ministrave dhe Kuvendi i Shqipërisë, prapësojnë se veprimtaria gjurmuese dhe hetimore që do të kryejë Byroja Kombëtare e Hetimit, sipas nenit 27, pika 2, të ligjit nr. 108/2014, është në përputhje me legjislacionin penal dhe procedural penal. Kjo strukturë nuk ka si qëllim të krijojë paralelizma apo të suprimojë veprimtarinë e organit të Prokurorisë dhe Policisë Gjyqësore, por të ndihmojë në luftën kundër korrupsionit. Krijimi i saj është diktuar nga nevojat imediate që ka vendi në parandalimin dhe hetimin e veprave penale në fushën e korrupsionit. Ligji nr. 108/2014 ka përcaktuar një raport llogaridhënie të Byrosë Kombëtare të Hetimit para drejtorit të Policisë së Shtetit për veprimtarinë gjurmuese dhe para Prokurorit për veprimtarinë hetimore procedurale. Në këtë mënyrë kontrolli i hetimeve përsëri i mbetet organit të Prokurorisë. Prokuroria mbikëqyr punën e kësaj Byroje me anën e kontrollit të hetimit, të formulimit dhe të ngritjes së aktakuzës.

12. Gjykata në jurisprudencën e saj, duke iu referuar nenit 7 të Kushtetutës, që parashikon parimin e ndarjes së pushteteve, ka theksuar se ky parim në demokraci si formë e qeverisjes synon kryesisht të mënjanojë rrezikun e përqendrimit të pushtetit në duart e një organi apo të personave të caktuar, gjë që praktikisht mbart me vete rrezikun e shpërdorimit të tij. Nëpërmjet këtij parimi kushtetutëbërësi ka përcaktuar për secilin nga organet që përfaqësojnë këto pushtete kompetencat që përputhen/i përgjigjen qëllimit të tij. Për sa kohë



këto kompetenca janë të përcaktuara nga normat kushtetuese, është e palejueshme që një organ tjetër t'i marrë ose t'i anashkalojë ato me vullnetin e tij (*shih vendimet nr. 24, datë 9.6.2011 dhe nr. 19, datë 3.5.2007 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Gjithsesi, parimi i ndarjes së pushteteve nuk duhet kuptuar që çdo pushtet është i mbyllur dhe i pakontrolluar nga askush. Ndarja e pushteteve midis tri degëve të qeverisjes garantohej vetëm nëpërmjet sistemit të kontrolleve dhe ekuilibrave. Në këtë mënyrë, sipas Kushtetutës, aq sa flitet për ndarje bëhet fjalë edhe për ekuilibër të pushteteve. Qëllimi i një koncepti të tillë kushtetues siguron që të parandalojë çdo degë të qeverisjes për të ushtruar një pushtet të pakufizuar. Kontrollat dhe ekuilibrat që njeh Kushtetuta i japin secilës degë pushtete që kompensojnë apo zbusin ato të degëve të tjera (*shih vendimin nr. 11, datë 27.5.2004 të Gjykatës Kushtetuese*). Ndonëse renditen njëri pas tjetrit, tri pushtetet e përmendura nuk qëndrojnë në varësi hierarkike nga njëri-tjetri dhe as nuk dominojnë apo i nënshtrohen ndikimeve reciproke *extra ligjore* (*shih vendimin nr. 11, datë 6.4.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Gjithashtu, Gjykata ka theksuar se krijimi i raporteve të balancuara ndërmjet pushteteve, si dhe organeve të tjera kushtetuese duhet të orientohet nga standardi kushtetues i bashkëpunimit. Parimi i ndarjes dhe balancimit të pushteteve dhe fryma e Kushtetutës pranojnë bashkëpunim dhe bashkëveprim ndërmjet tyre, por kjo duhet të organizohet në mënyrë të tillë që parimet e lartpërmendura të mos shkelen (*shih vendimet nr. 10, datë 6.3.2014 dhe nr. 20, datë 9.7.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Për parimin e sanksionuar në nenin 7 të Kushtetutës, Gjykata është shprehur se ai shtrihet jo vetëm ndaj tri degëve të pushtetit, ekzekutiv, legjislativ dhe gjyqësor, por edhe ndaj organeve të tjera kushtetuese të pavarura, kompetencat e të cilave janë të parashikuara nga dispozitat e Kushtetutës. Sipas këtij parimi, asnjë organ, në përbërje ose jo të një prej tri pushteteve, nuk mund të ndërhyjë në trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve që, sipas rastit, do të përbënin objektin qendror të veprimtarisë së organeve apo institucioneve të tjera kushtetuese (*shih vendimin nr. 15, datë 15.4.2010 të Gjykatës Kushtetuese*). Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se

parimi i ndarjes dhe balancimit të pushteteve gjen zbatim edhe në raportin ndërmjet organit të Prokurorisë dhe Byrosë Kombëtare të Hetimit.

16. Gjykata po ashtu ka theksuar se normat kushtetuese nuk mund të interpretohen si norma të izoluar, por duhen parë në harmoni me normat e tjera kushtetuese. Një qëndrim i tillë bazohet në faktin se asnjë dispozitë e Kushtetutës nuk mund të nxirret jashtë kontekstit të saj dhe të interpretohet më vetë, pasi çdo dispozitë kushtetuese duhet të interpretohet në mënyrë që të jetë e pajtueshme me parimet themelore kushtetuese, kjo për arsye se të gjitha normat dhe parimet kushtetuese formojnë një sistem harmonik pa kontradikta të brendshme (*shih vendimin nr. 25, datë 24.7.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Nga sa më lart, si dhe bazuar në parashtrimet e palëve, Gjykata çmon se pretendimi i kërkuesit për cenimin e parimit të ndarjes dhe balancimit të pushteteve duhet të shqyrtohet në përputhje me parimin kushtetues të shtetit të së drejtës, të sanksionuar në nenin 4 të Kushtetutës, që përcakton se “E drejta përbën bazën dhe kufijtë e veprimtarisë së shtetit. Kushtetuta është ligji më i lartë në Republikën e Shqipërisë. Dispozitat e Kushtetutës zbatohen drejtpërsëdrejti, përveç rasteve kur Kushtetua parashikon ndryshe”, si dhe me nenin 148 të Kushtetutës, sipas të cilit ndjekja penale është atribut ekskluziv i organit të Prokurorisë.

18. Në këtë drejtim, Gjykata në jurisprudencën e saj tashmë të konsoliduar është shprehur se parimi i shtetit të së drejtës detyron të gjitha organet e pushtetit publik që t'i ushtrojnë kompetencat e tyre vetëm në kuadër dhe në bazë të normave kushtetuese (*shih vendimet nr. 5, datë 5.2.2014 dhe nr. 1, datë 12.1.2011 të Gjykatës Kushtetuese*). Aktet juridike që nxirren nga këto organe duhet të jenë në pajtim me aktet juridike më të larta si në kuptimin formal, ashtu edhe atë material (*shih vendimet nr. 5, datë 5.2.2014 dhe nr. 23, datë 8.6.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Për sa i përket nenit 148/1 të Kushtetutës, funksioni i organit të Prokurorisë, si përfaqësues i akuzës në emër të shtetit, bën që ky organ të ketë të drejtën ekskluzive të vendosë ndjekjen penale ose jo, d.m.th., të shpjerë ose jo një çështje në gjyq, ta pushojë ose jo një çështje në fazën e gjykimit. Lidhur me këtë organ Gjykata



ka vlerësuar se ai ka disa veçori, të cilat janë përcaktuar në Kushtetutë e në ligj dhe që e vendosin këtë organ në një pozitë të dallueshme nga pushtetet e tjera, dhe veçanërisht: a) si organi i vetëm në vend që ushtron ndjekjen penale; b) si organi që përfaqëson akuzën në gjyq në emër të shtetit, që disponon mbi çështjet që ndodhen në gjykim dhe që është i lirë në kërkimin e llojit dhe të masës së dënimit ndaj personave që i rezultojnë fajtorë; c) si organ me pavarësi të plotë në ushtrimin e funksioneve, duke iu nënshtruar vetëm Kushtetutës dhe ligjeve, gjë që do të thotë se fillimi i procedimit penal, vënia para përgjegjësisë penale, pushimi, pezullimi i çështjeve ose dërgimi në gjyq janë attribute të Prokurorisë; d) si organi i centralizuar që funksionon sipas rregullit, se urdhrat dhe udhëzimet e prokurorit më të lartë janë të detyrueshme për prokurorët më të ulët, ndërsa ligjshmëria e vendimeve ose e veprimeve, si dhe rregullsia ose plotësia e hetimeve të kryera nga prokurorët më të ulët kontrollohen vetëm nga prokurori më i lartë (neni 24/4/5 i KPP-së), me përjashtim të rasteve kur ligji procedural ia njeh gjykatës një të drejtë të tillë (*shih vendimet nr. 26, datë 4.12.2006 dhe nr. 12, datë 20.5.2008 të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Nën frymën e dispozitave kushtetuese, edhe Kodi i Procedurës Penale ka përcaktuar parimet kryesore të procedimit penal, subjektet e procedimit penal dhe kompetencat e tyre, si dhe raportet ndërmjet këtyre subjekteve. Këto parime, gjithashtu, gjejnë pasqyrim në ligjin nr. 8737, datë 12.2.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në ligjin nr. 8677, datë 2.11.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”.

21. Konkretisht, neni 277 i KPP-së ka përcaktuar se organet e ngarkuara për hetimet paraprake janë prokurori, i cili drejton hetimet, dhe Policia Gjyqësore në dispozicion të tij. Policia Gjyqësore me marrjen e njoftimit për një vepër penale, pa vonesë, i referon prokurorit, me shkrim, elementet thelbësore të faktit dhe elementet e tjera që janë mbledhur (neni 293 i KPP-së). Ajo kryen çdo veprim hetimor që i është urdhëruar ose deleguar nga prokurori (neni 30/2 i KPP-së). Po në këtë drejtim, neni 33/1 i KPP-së sanksionon se seksionet e Policisë

Gjyqësore varen nga drejtuesit e prokurorive të rretheve.

22. Neni 4 i ligjit nr. 8677, datë 2.11.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore” parashikon: “Në ushtrimin e detyrave dhe të funksioneve të saj, Policia Gjyqësore është në varësi dhe drejtohet e kontrollohet nga prokurori”. Ndërsa ligji nr. 8737, datë 12.2.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë” në nenin 56/a të tij përcakton marrëdhëniet e prokurorit me Policinë Gjyqësore: “1. Prokurorët drejtojnë dhe kontrollojnë veprimtarinë hetimore të Policisë Gjyqësore. ... 2. Prokurori ka të drejtë: a) t’i japë urdhra dhe udhëzimet e dubura Policisë Gjyqësore”.

23. Nga sa më lart, Gjykata vlerëson se Kushtetuta në nenin 148 të saj e ka konceptuar organin e Prokurorisë si të vetmin organ përgjegjës për ushtrimin e ndjekjes penale, pjesë përbërëse e të cilës është edhe hetimi i çështjeve penale. Ndonëse Prokuroria është organ i centralizuar, veprimtaria hetimore është e decentralizuar. Ajo ushtrohet si kryesisht nga vetë prokurori, ashtu edhe nga Policia Gjyqësore. Kjo e fundit funksionon pranë organeve të ndryshme që kryejnë edhe funksione me karakter policor, të tilla si strukturat pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme, Ministrisë së Financave etj. Pavarësisht strukturave ku ushtron funksionin Policia Gjyqësore, çfarë e karakterizon atë është se veprimtaria e saj hetimore kryhet nën mbikëqyrjen, drejtimin dhe kontrollin e drejtpërdrejtë të prokurorit.

24. Gjithashtu, KPP-ja dhe ligjet organike, përkatësisht të organit të Prokurorisë dhe atij të Policisë Gjyqësore përcaktojnë me hollësi dhe në mënyrë të qartë rregullat e ndjekjes penale, të hetimit dhe gjykit, organet e ngarkuara për hetimet paraprake, sferën e kompetencës së secilit organ, si dhe raportin e vartësisë ndërmjet tyre, veçanërisht ndërmjet prokurorit dhe Policisë Gjyqësore. Këto rregulla, sipas dispozitës së nenit 2 të KPP-së, janë të detyrueshme për subjektet e procedimit penal, organet shtetërore, personat juridikë dhe shtetasit në funksion të garantimit të një procedimi të drejtë, të barabartë e të rregullt ligjor, si dhe të mbrojtjes së lirive dhe të drejtave të individit (neni 1 i KPP-së). Për rrjedhojë, Gjykata çmon se krijimi i subjekteve të reja, përveç atyre të parashikuara në KPP, me kompetenca në fushën



e ndjekjes penale, kërkon detyrimisht jo vetëm respektimin e parimeve kushtetuese, por edhe harmonizimin e kompetencave të tyre me dispozitat përkatëse të KPP-së.

25. Në rastin konkret, Gjykata vëren se ligji objekt shqyrtimi në kreun VI parashikon krijimin dhe funksionimin e Byrosë Kombëtare të Hetimit, si strukturë e veçantë e Policisë së Shtetit, që ushtron si veprimtari të saj atë të gjurmimit dhe hetimit për veprat penale në fushën e korrupsionit dhe të veprimtarisë kriminale të lidhur me të (neni 27). Në relacionin për (projekt) ligjin në fjalë lexohet se qëllimi i krijimit të saj është të bëjë të mundur rritjen e efektivitetit në luftën ndaj korrupsionit dhe krimit të organizuar.

26. Gjykata, nga analiza e dispozitave të ligjit të kundërshtuar, konstaton se:

a) fusha e veprimtarisë së kësaj strukture, sipas nenit 6, pikat 28 dhe 29, të ligjit, konsiston në kërkimin, gjetjen, grumbullimin, administrimin, verifikimin, analizimin e të dhënave dhe informacioneve për veprimtari kriminale, si dhe në veprimtarinë hetimore në përputhje me KPP-në;

b) objekti i veprimtarisë së strukturës ka të bëjë me *“veprat penale në fushën e korrupsionit dhe veprimtarinë kriminale të lidhur me të”* (neni 27/2) apo *“veprat penale në fushën e korrupsionit dhe vepra të tjera të lidhura me to”* (neni 36/1);

c) organizimi dhe funksionimi i saj është në kompetencë të ministrit përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike (neni 27/4), i cili, gjithashtu, emëron dhe shkarkon drejtuesin e Byrosë Kombëtare të Hetimit (neni 30). Ministri kryeson edhe Komitetin Kombëtar Koordinues, i cili përcakton përparësitë kryesore të veprimtarisë parandaluese dhe hetimore të Byrosë Kombëtare të Hetimit, duke formuluar detyrat kryesore strategjike të saj (neni 35);

ç) punonjësit e Byrosë, sipas nenit 36 të ligjit, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me iniciativën e tyre, duhet të marrin dijeni për veprat penale në fushën e korrupsionit dhe vepra të tjera të lidhura me to, të pengojnë ardhjen e pasojave të mëtejshme, të kërkojnë autorët e tyre, të mbledhin dhe të administrojnë çdo të dhënë të ligjshme, si dhe të kryejnë hetime që i shërbejnë zbatimit të ligjit penal.

27. Nga sa më lart, Gjykata vëren se ndonëse ligji krijon një subjekt të ri me kompetenca në fushën e hetimit të veprave penale, atij i

mungojnë tërësisht dispozitat lidhur me pozitën procedurale të këtij subjekti në raport me Prokurorinë, si i vetmi organ përgjegjës për ndjekjen penale, por edhe me subjektet e tjera të procedimit penal, të parashikuara në KPP.

28. Pretendimi i subjekteve të interesuara se Byroja Kombëtare e Hetimit do të përgjigjet për veprimtarinë gjurmuese para drejtorit të Policisë së Shtetit dhe për veprimtarinë hetimore para Prokurorit, gjen pasqyrim vetëm në relacionin e projektligjit në fjalë, por nuk parashikohet në asnjë nen të vetë ligjit.

29. Gjykata vlerëson, gjithashtu, se me probleme paraqitet edhe objekti i veprimtarisë së Byrosë Kombëtare të Hetimit. Sipas dispozitave të ligjit, sikurse u përmend më lart, ky organ do të kryejë veprimtari gjurmuese dhe hetimore për *“veprat penale në fushën e korrupsionit dhe veprimtarinë kriminale të lidhur me të”* (neni 27/2) apo *“veprat penale në fushën e korrupsionit dhe vepra të tjera të lidhura me to”* (neni 36/1). Një përcaktim i tillë i përgjithshëm, pa specifikuar konkretisht dispozitat përkatëse të KPP-së, jo vetëm krijon paqartësi dhe konfuzion në ushtrimin normal dhe në përputhje me ligjin e veprimtarisë së këtij organi, por njëkohësisht mund të sjellë përplasje me veprimtaritë që ushtrojnë strukturat e tjera, pjesë e Policisë Gjyqësore, që veprojnë në fushën e tatimeve, të taksave, doganave etj. Akoma më i paqartë është ligji kur shprehet se pjesë e veprimtarisë gjurmuese dhe hetimore të Byrosë Kombëtare të Hetimit janë përveç veprave penale në fushën e korrupsionit edhe *“veprat e tjera të lidhura”* me to. Edhe gjatë seancës plenare përfaqësuesit e subjekteve të interesuara, Këshilli i Ministrave apo Kuvendi i Shqipërisë, nuk arritën të sqarojnë se për çfarë veprash penale bëhet fjalë.

30. Nisur nga sa më sipër, Gjykata vlerëson se mungesa në ligjin objekt shqyrtimi e rregullimeve që përcaktojnë raportet procedurale midis Byrosë Kombëtare të Hetimit dhe organit të Prokurorisë, si dhe pozitën e këtij organi në raport me Policinë Gjyqësore, mospërcaktimi i saktë dhe i hollësishëm jo vetëm i kompetencave, por edhe i sferës së veprimtarisë, e bëjnë atë të paplotë, të paqartë, duke krijuar probleme me zbatimin në praktikë të ligjit dhe në mënyrë të veçantë me efektivitetin e veprimtarisë së këtij organi.



31. Në këtë këndvështrim, parashikimi i vetëm se veprimtaria e Byrosë kryhet në përputhje me legjislacionin penal dhe procedural penal, në vlerësimin e Gjykatës nuk është i mjaftueshëm për të sqaruar në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme raportin ndërmjet Byrosë Kombëtare të Hetimit dhe organit të Prokurorisë. Ai përbën thjesht një referim të përgjithshëm. Gjykata thekson se sfera e kompetencës së këtij subjekti, raportet e tij me organin e Prokurorisë, si dhe me organet e gjurmimit dhe të hetimit duhet të përcaktohen në mënyrë të saktë duke iu referuar dispozitave të KPP-së, si ligji bazë që përcakton rregullat për mënyrën e ushtrimit të ndjekjes penale, të hetimit dhe të gjykitimit (neni 2 i KPP-së).

32. Në kuadër të respektimit të parimit të sigurisë juridike, Gjykata ka theksuar se vetë siguria juridike, si element i shtetit të së drejtës, ka si kërkesë të domosdoshme që ligji në tërësi apo dispozita të veçanta të tij, në përmbajtjen e tyre duhet të jenë të qarta, të përcaktuara dhe të kuptueshme (*vendimi nr. 9, datë 26.2.2007 i Gjykatës Kushtetuese*). Për të kuptuar dhe zbatuar drejt parimin e sigurisë juridike, kërkohet, nga njëra anë, që ligji në një shoqëri të ofrojë siguri, qartësi dhe vazhdimësi, në mënyrë që individët t'i drejtojnë veprimet e tyre në mënyrë korrekte e në përputhje me të dhe, nga ana tjetër, që vetë ligji të mos qëndrojë statik nëse duhet t'i japë formë një koncepti. Një rregullim i pasaktë i normës ligjore, që i lë shteg zbatuesit t'i japë asaj kuptime të ndryshme dhe që sjell pasoja, nuk shkon në përputhje me qëllimin, stabilitetin, besueshmërinë dhe efektivitetin që synon vetë norma (*vendimi nr. 36, datë 15.10.2007 dhe nr. 52, datë 1.12.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

33. Gjithashtu, Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se mungesa e harmonizimit të dispozitave të një ligji me ato të ligjeve të tjera mund të mos krijojë në vetvete antikushtetutshmëri, por kur paqartësia krijon probleme të tilla që çojnë në zbatim të gabuar të dispozitave ligjore dhe në cenim të parimit të shtetit të së drejtës e të sigurisë juridike, atëherë nuk mund të pranohet se këto norma janë të pajtueshme edhe me frymën e Kushtetutës (*shih vendimin nr. 14, datë 22.5.2006 të Gjykatës Kushtetuese*).

34. Po në këtë drejtim, Gjykata është shprehur që ligjet e zakonshme duhet të nxirren jo vetëm

në bazë dhe për zbatim të Kushtetutës, por duhet treguar kujdes i veçantë që ato të mos prekin rregullimet që përfshihen natyrshëm në sferën ekskluzive të ligjeve të *cilësuar* (*shih vendimin nr. 19, datë 3.5.2007; nr. 9, datë 23.3.2010; nr. 23, datë 8.6.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

35. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se parashikimet ligjore të kreut VI, të ligjit nr. 108/2014, jo vetëm që nuk sjellin përmirësim në fushën e hetimit të veprave penale kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, por ofrojnë disa zgjidhje që shkojnë në kundërshtim me qëllimin që synon ligjvënësi, sepse bien ndesh me parimet kushtetuese, dhe si të tilla mund të çojnë në cenimin e shtetit të së drejtës dhe të drejtave dhe lirive të individit.

36. Përveç sa më sipër, Gjykata thekson se fakti që emërimi, lrimi nga detyra dhe shkarkimi i drejtuesit të Byrosë Kombëtare të Hetimit është në kompetencë të ministrit të Punëve të Brendshme (neni 30), i cili kryeson Komitetin Kombëtar Koordinues, që përcakton përparësitë kryesore të veprimtarisë parandaluese dhe hetimore të Byrosë Kombëtare të Hetimit (neni 35), krijon premisa varësie të këtij organi nga pushteti ekzekutiv. Kjo varësi, gjithashtu, do të nënkuptonte një influencë/ndërhyrje të pushtetit ekzekutiv në fazën fillestare të ndjekjes penale, atë të hetimeve paraprake, çka do të ndikonte në krijimin e raporteve të pabalancuara ndërmjet pushtetit ekzekutiv, nga njëra anë, dhe organit të Prokurorisë, nga ana tjetër (tagër ekskluzive e të cilit është ndjekja penale). Pikërisht për të shmangur këtë rrezik, në funksion edhe të respektimit të parimit të ndarjes dhe balancimit të pushteteve, ligjvënësi procesin e emërimit dhe të shkarkimit të punonjësve të Policisë Gjyqësore e ka konsideruar si një përgjegjësi të dyanshme, midis Prokurorit të Përgjithshëm, nga njëra anë, dhe ministrit që ka në kompetencë forcën policore, nga ana tjetër (neni 10/a i ligjit organik të Policisë Gjyqësore). Për pasojë, Gjykata vlerëson se një parashikim i tillë bie ndesh me parimin e shtetit të së drejtës dhe atë të ndarjes dhe balancimit të pushteteve.

37. Lidhur me kompetencën e ministrit të Brendshëm për të përcaktuar (me akte nënligjore) organizimin dhe *funksionimin* e Byrosë Kombëtare të Hetimit (neni 27), Gjykata çmon të sjellë në vëmendje vendimin nr. 10, datë



6.3.2014 me objekt kontrollin e kushtetutshmërisë së ligjit nr. 109/2013, datë 1.4.2013, “Për administratën gjyqësore në Republikën e Shqipërisë”, në të cilin ajo ka konstatuar cenimin e parimit të ndarjes dhe balancimit të pushteteve për shkak se dispozitat e ligjit i jepnin të drejtën ministrit të Drejtësisë që të përcaktonte me akte nënligjore momente të ndryshme e të rëndësishme të veprimtarisë së administratës gjyqësore. Në këtë vendim, Gjykata, lidhur me raportin ndërmjet pushtetit ekzekutiv (ministri i Drejtësisë) dhe pushtetit gjyqësor, është shprehur se *“për efekt të rëndësisë që paraqet parimi i ndarjes dhe balancimit të pushteteve, garancitë që ofron ligjvënësi në kuptim të këtij parimi duhet të jenë integrale e të përshkallëzuara nga niveli menaxhues deri në atë ekzekutues. Në këtë drejtim, çdo rregullim i ri ligjor nuk është i mjaftueshëm nëse nuk garanton shmangien e ndikimeve që mund të ushtrojë pushteti ekzekutiv në çështje që lidhen me dhënien e drejtësisë nga gjykata. Në kushtet kur kompetencat e ministrit të Drejtësisë, sipas ligjit objekt shqyrtimi, shtrihen deri në çështjet e emërimit dhe të shkarkimit të personelit ndihmës në gjykatë, mund të krijohen edhe premisa influence të këtij autoriteti në këtë aspekt. [...] Përcaktimi i kompetencave përtej standardeve kushtetuese do të krijonte raporte të pabalancuara ndërmjet funksioneve e, për rrjedhojë, edhe ndërmjet pushteteve ku bën pjesë secili prej tyre”*.

38. Pretendimi i subjektit të interesuar, Kuvendi të Shqipërisë, se në krijimin e këtij organi dhe në hartimin e ligjit është marrë për bazë modeli sloven, nuk përbën argument kushtetues për shkak të diferencave të ndjeshme në sistemin kushtetues dhe juridik midis dy vendeve. Sipas modelit sloven, Byroja është njësi autonome në kryerjen e detyrave të saj, siç është edhe Policia e Shtetit në çdo vend demokratik si në nivelet profesionale, ashtu edhe operacionale. Drejtori i saj emërohet nga drejtori i përgjithshëm i Policisë dhe jo nga një funksionar politik, si ministri i Brendshëm. Për më tepër vendimi i tij është objekt i një opinionit të favorshëm të dhënë nga një komitet i posaçëm ekspertësh, në përbërje të të cilit është edhe një përfaqësues i Këshillit të Prokurorisë së Shtetit. I njëjti pëlqim duhet edhe për shkarkimin e drejtorit të Byrosë. Gjithashtu, ndryshe nga Shqipëria, prokurorët në Slloveni emërohen nga Qeveria.

39. Gjykata, me këtë rast, e çmon me vend të theksojë se edhe pse modelet e huazuara nga vendet e tjera kanë rëndësinë e tyre,

implementimi i ligjeve të huaja apo krijimi i organeve të ngjashme duhet të bëhet gjithmonë në përputhje me rendin tonë juridik dhe kushtetues. Në të kundërt, nisma të tilla të pakoordinuara krijojnë premisa për deformimin e sistemit të ndjekjes penale.

40. Për pasojë, Gjykata vlerëson se parashikimet e kreut VI, të ligjit nr. 108/2014, bien ndesh me parimin e shtetit të së drejtës dhe parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve, të sanksionuara përkatësisht në nenet 4 dhe 7 të Kushtetutës. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkuarit në këtë drejtim është i bazuar.

Ç. Për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor

41. Kërkuari pretendon se veprimtaria gjurmuese dhe hetimore që ligji sanksionon të kryhet nga Byroja Kombëtare e Hetimit cenon të drejtën kushtetuese të çdo individit për një proces të rregullt ligjor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, si dhe nuk respekton parimin e ligjshmërisë.

42. Gjykata, nën dritën e jurisprudencës së GJEDNJ-së (*shih çështjet Von Hoffen kundër Litenshtejnit*, 2 korrik 2006 §.35; *Hozee kundër Holandës*, 22 maj 1998 § 43), ka theksuar se procesi i rregullt ligjor dhe gjykimi brenda një afati të arsyeshëm shtrihet edhe gjatë fazës së hetimeve paraprake (*shih vendimin nr. 47, datë 7.11.2011 të Gjykatës Kushtetuese*). Kjo do të thotë se garancitë e parashikuara në nenin 42 të Kushtetutës, si dhe në nenin 6 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (KEDNJ) zbatohen jo vetëm ndaj proceseve gjyqësore, por edhe në fazat që e paraprijnë, sikurse në ato që e vijojnë. Në çështjet penale këto garanci përfshijnë para së gjithash hetimet e kryera nga Policia.

43. Gjykimi nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj, është një nga elementet e rëndësishme të procesit të rregullt ligjor, i garantuar nga neni 42 i Kushtetutës. Nga sa më lart, Gjykata vlerëson se edhe organet e tjera, që nuk janë gjykata, por që ushtrojnë funksione që janë përcaktuese në sferën e të drejtave dhe lirive themelore të individit, duhet të jenë të pavarura dhe të paanshme në veprimtarinë e tyre. Për rrjedhojë, çdo individ ka të drejtë të hetohet nga një organ i pavarur dhe i



paanshëm i caktuar me ligj, në mënyrë që ai (organi) të jetë i aftë të veprojë pa asnjë influencë nga kushdo dhe për çfarëdolloj arsye. Me fjalët të tjera këto organe duhet të ushtrojnë veprimtarinë tyre në mënyrë të pavarur nga çdo organ tjetër, si dhe të veprojnë vetëm në zbatim të normave të së drejtës.

44. Në rastin në shqyrtim, përveç problemeve të trajtuara më lart, Gjykata vlerëson se bashkimi në një “dorë” i veprimtarisë gjurmuese me atë hetimore (neni 27/2), është një zgjedhje e papërshtatshme dhe e papranueshme në një sistem juridiko-penal të bazuar në modelin akuzator, në të cilin kërkohet një ndarje e saktë midis funksioneve të gjurmimit, hetimit, ndjekjes penale dhe gjykimit të çështjes. Një bashkim i tillë krijon premisa potenciale për arbitraritet, me pasojë cenimin e të drejtave dhe interesave të ligjshme të pjesëmarrësve në proces, si dhe cenimin e parimit të ligjshmërisë, si parim bazë i procesit penal.

45. Gjykata vlerëson se përderisa kreu VI i ligjit nr. 108/2014 paraqet probleme të natyrës së lartpërmendur, të cilat përmbajnë në vetvete rrezikun e cenimit të të drejtave dhe lirive të individit për një proces të rregullt ligjor, ai bie ndesh edhe me nenin 42 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së. Për rrjedhojë, edhe ky pretendim i kërkuesit është i bazuar.

D. Për cenimin e nenit 116 të Kushtetutës

46. Sipas kërkuesit kompetencat e Byrosë Kombëtare të Hetimit bien ndesh edhe me dispozitat (nenet 30, 277, 293, 304) e Kodit të Procedurës Penale, të cilat përcaktojnë kompetencat e prokurorit në ndjekjen e veprës penale. Për pasojë, përplasjet midis dispozitave të ligjit të kundërshtuar dhe KPP-së, ky i fundit i miratuar me shumicë të cilësuar, nuk respektojnë nenin 116 të Kushtetutës. Sipas tij, në respekt të parimit të hierarkisë së akteve normative, ligjet e zakonshme duhet të nxirren jo vetëm në bazë dhe për zbatim të Kushtetutës, por duhet treguar kujdes i veçantë që ato të mos jenë në kundërshtim edhe me ligjet me shumicë të cilësuar.

47. Respektimi i hierarkisë së akteve normative është një detyrim që rrjedh nga parimi i shtetit të së drejtës dhe i koherencës në sistemin ligjor (*shih vendimin nr. 2, datë 3.2.2010 të Gjykatës Kushtetuese*). Piramida e akteve normative, e

sanksionuar në nenin 116 të Kushtetutës, përcakton marrëdhëniet midis normave juridike, të cilat bazohen në raportin e mbi/nënvendosjes së tyre. Rendi juridik nuk është një radhitje e barasvlershme normash, por një sistem hierarkik, i cili përbëhet nga nivele të ndryshme vlefshmërie dhe në secilin prej këtyre niveleve qëndron një normë ose grup normash, duke përfutur kështu edhe fuqinë e caktuar juridike. Kjo piramidë aktesh normative ka në majë të saj Kushtetutën, e cila shërben si burim për aktet e tjera juridike (*shih vendimet nr. 3, datë 20.2.2006 dhe nr. 5, datë 5.2.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

48. Gjykata ka theksuar se nuk është detyrë e saj shqyrtimi i përplasjeve dhe papajtueshmërive mes dy ligjeve të ndryshme apo ligjeve dhe kodeve. Në juridiksionin kushtetues hyjnë papajtueshmëria e ligjeve apo e kodeve me Kushtetutën (*shih vendimet nr. 35, datë 10.10.2007 dhe nr. 1, datë 6.2.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

49. Gjykata vlerëson se pavarësisht nga sa u tha më lart, kur mungesa e harmonizimit të dispozitave të një ligji me ato të ligjeve të tjera mund të krijojë antikushtetutshmëri të tij për shkak të cenimit të parimit të sigurisë juridike, ndarjes dhe balancimit të pushteteve (*shih paragrafin 33*), referuar natyrës së pretendimit të kërkuesit, mungesa e harmonizimit të kompetencave të Byrosë Kombëtare të Hetimit me parashikimet e KPP-së, lidhur me hetimin e veprave penale, ndonëse krijon përplasje midis një ligji të miratuar me shumicë të thjeshtë dhe KPP-së të miratuar me shumicë të cilësuar, sipas jurisprudencës së kësaj Gjykate, nuk cenon parimin e hierarkisë së normave juridike, të parashikuar nga neni 116 i Kushtetutës. Për pasojë, ky pretendim i kërkuesit duhet rrëzuar.

DH. Për cenimin e parimit të sigurisë juridike nga neni 49 i ligjit të kundërshtuar

50. Kërkuesi pretendon se disponimet e nenit 49 të ligjit në fjalë, sipas të cilit një person mund të rikthehet në Polici vetëm nëse ai ka ndërprerë marrëdhëniet e punës me strukturat e saj brenda 2 viteve të fundit dhe është liruar nga Policia për shkurtim të funksionit, kanë përkeqësuar gjendjen e mëparshme të punonjësit të Policisë, duke cenuar pozitën e një kategorie të gjerë punonjësish. Në këtë mënyrë ato bien ndesh me parimin e sigurisë juridike.

51. Subjektet e interesuara, Këshilli i Ministrave dhe Kuvendi i Shqipërisë, prapësojnë se



parashikimi në ligj i kriterëve të reja për rikthimin në punë të punonjësit të Policisë së Shtetit shërben si garanci për të shmangur lëvizjet e shumta të personelit, të kushtëzuara nga hyrjet e daljet në Polici.

52. Gjykata është shprehur se parimi i sigurisë juridike kërkon, para së gjithash, që rregullimet ligjore, të cilat, kanë të bëjnë me të drejtat e shtetasve të kenë qëndrueshmëri të mjaftueshme që siguron vijimësinë e tyre. Si rregull, nuk mund të mohohen interesat dhe pritshmëritë të ligjshme të qytetarëve nga ndryshimet në legjislacion dhe shteti duhet të synojë ndryshimin e një situate të rregulluar më parë vetëm nëse ndryshimi përmirëson të drejtat e fituara. Sanksionimi i të drejtave dhe lirive të njeriut, të pranuar në Kushtetutë, dhe shoqërimi i tyre me masat për vënien në jetë të tyre duhet të synojë përmirësimin dhe rritjen e standardeve të të drejtave në kuadër të forcimit të shtetit ligjor. Nëse masat e marra çojnë në përkeqësimin, në mënyrë të paarsyeshme, të gjendjes ligjore të personave të tjerë, mohojnë të drejtat e fituara ose injorojnë interesat legjitime të këtyre, atëherë do të dhunohet parimi kushtetues i barazisë së të drejtave dhe, në përgjithësi, do të rrezikohet arritja e qëllimit madhor të ndërtimit të shtetit të së drejtës (*shih vendimin nr. 9, datë 26.2.2007 të Gjykatës Kushtetuese*).

53. Megjithatë, Gjykata ka evidentuar se parimi i sigurisë juridike nuk mund të prevalojë në çdo rast. Kjo do të thotë se nëse paraqitet rasti që një rregullim ligjor i ndryshëm i një marrëdhënieje ndikohet drejtpërdrejt nga një interes publik, me të gjitha elementet e tij thelbësore, ky interes natyrisht do të ketë përparësi ndaj parimit të sigurisë juridike (*shih vendimet nr. 26/2005; nr. 10/2008; nr. 33/2010; nr. 43, datë 6.10.2011; nr. 34, datë 28.5.2012; nr. 37, datë 13.6.2012; nr. 2, datë 18.2.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

54. Në këtë kontekst, Gjykata, në respekt të parimit të ndarjes së pushteteve, ka theksuar se nuk mund të kontrollojë ose të orientojë paraprakisht vullnetin e ligjvënësit që të veprojë ose jo në një kohë të caktuar dhe, në të njëjtën linjë arsyetimi, nuk mund të përbëjë çështje të juridiksionit kushtetues vlerësimi i arsyeve që mund të kenë ndikuar te ligjvënësi për trajtim të posaçëm të një çështjeje të caktuar, të ndryshme

nga ajo që rregullon ligji konkret, pasi është brenda marzhit vlerësues të ligjvënësit mënyra e rregullimit të një çështjeje të caktuar, ndërsa është detyrë e Gjykatës të kontrollojë nëse rregullimi me ligj i kësaj çështjeje është bërë në përputhje me Kushtetutën dhe parimet themelore të saj (*shih vendimin nr. 30, datë 1.12.2005 të Gjykatës Kushtetuese*).

55. Në vështrim të sa më sipër, Gjykata vlerëson se rregullimi i bërë në nenin 49 të ligjit nuk krijon probleme të natyrës kushtetuese. Për më tepër, kërkuksi, pretendimin e tij nuk ka mundur ta ngrejë në nivel kushtetues, prandaj ai duhet rrëzuar.

56. Si përfundim, Gjykata vlerëson se krijimi i një strukture të re, Byrosë Kombëtare të Hetimit, në varësi të ministrit të Brendshëm, si strukturë e veçantë e Policisë së Shtetit, me objekt gjurmimin dhe hetimin e veprave penale në fushën e korrupsionit, si dhe të veprimtarinë kriminale të lidhur me të, cenon parimin e shtetit të së drejtës, të sigurisë juridike, të ndarjes dhe balancimit të pushteteve, si dhe të drejtat e individit për një proces të rregullt ligjor, të parashikuara respektivisht nga nenet 4, 7 dhe 42 të Kushtetutës, si dhe nga neni 6 i KEDNJ-së, për shkak të mungesës së harmonizimit të kompetencave të saj me dispozitat përkatëse të KPP-së për hetimin e veprave penale, si dhe të mospërcaktimit të raporteve procedurale të kësaj strukture me Prokurorinë dhe subjektet e tjera të hetimit. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se kreu VI i ligjit nr. 108/2014 duhet të shfuqizohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, duke u bazuar në nenet 131, shkronja “a” dhe 134, paragrafi 1, shkronja “c”, të Kushtetutës, si dhe në nenet 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash

VENDOSI:

- Pranimin pjesërisht të kërkesës.
- Shpalljen si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të kreut VI “Byroja Kombëtare e Hetimit” (nenet 27-36) të ligjit nr. 108/2014, “Për Policinë e Shtetit”.
- Rrëzimin e kërkesës për shfuqizimin e nenit 49 të këtij ligji.



Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Vitore Tusha, Gani Dizdari, Fatmir Hoxha, Vladimir Kristo, Fatos Lulo, Besnik Imeraj

Anëtarë kundër: Bashkim Dedja (kryetar), Sokol Berberi

Anëtarë pjesërisht kundër: Altina Xhoxhaj¹

MENDIM PAKICE

1. Në çështjen me kërkesë një grup deputetësh të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, me objekt kontrollin e pajtueshmërisë me Kushtetutën të dispozitave të kreut VI “Byroja Kombëtare e Hetimit” (nenet 27-36) të ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i jam bashkuar shumicës vetëm për sa i përket përmbajtjes së neneve 27/2 dhe 36/1 të këtij ligji, dhe më konkretisht vetëm në pjesën që i njohin të drejtën kësaj strukture për të kryer veprimtari hetimore veç asaj gjurmuese. Ndërkohë që jam kundër qëndrimit të shumicës për shfuqizimin e të gjithë kreut VI të ligjit nr.108/2014, për arsye se në vlerësimin tim përmbajtja e dispozitave të tjera të këtij kreu nuk paraqet asnjë problem kushtetutshmërie.

2. Sipas nenit 27/1, të ligjit nr. 108/2014, Byroja Kombëtare e Hetimit organizohet si strukturë e veçantë e Policisë së Shtetit. Sipas nenit 27/2 kjo strukturë kryen veprimtari gjurmuese dhe hetimore, në përputhje me legjislacionin penal dhe procedural penal, për veprat penale në fushën e korrupsionit dhe veprimtarinë kriminale të lidhur me të. Sipas nenit 36/1 të ligjit punonjësit e Byrosë, në përputhje me legjislacionin në fuqi, edhe me iniciativën e tyre, duhet të marrin dijeni për veprat penale në fushën e korrupsionit dhe vepra të tjera të lidhura me to, të pengojnë ardhjen e pasojave të mëtejshme, të kërkojnë autorët e tyre, të mbledhin dhe të administrojnë çdo të dhënë të ligjshme, si dhe të kryejnë hetime që i shërbejnë zbatimit të ligjit penal.

3. Të dyja këto dispozita, të cilat parashikojnë fushën e kompetencave të Byrosë së Hetimit, i kanë dhënë kësaj strukture edhe të drejtën e

kryerjes së veprimeve hetimore, çka është një funksion që nuk përputhet me funksionet dhe detyrat që ushtrojnë punonjësit dhe strukturat e Policisë së Shtetit. Sipas nenit 148 të Kushtetutës Prokuroria ushtron ndjekjen penale, përfaqëson akuzën në gjyq në emër të shtetit, si dhe kryen detyra të tjera të caktuara me ligj. Kjo dispozitë kushtetuese e ka konceptuar organin e Prokurorisë si të vetmin organ përgjegjës për ushtrimin e ndjekjes penale, pjesë përbërëse e së cilës është edhe hetimi i çështjeve penale. Nën frymën e dispozitave kushtetuese edhe Kodi i Procedurës Penale ka përcaktuar parimet kryesore të procedimit penal, subjektet e procedimit penal dhe kompetencat e tyre, si dhe raportet ndërmjet këtyre subjekteve. Konkretisht, neni 277 i KPP-së ka përcaktuar se organet e ngarkuara për hetimet paraprake janë prokurori, i cili drejton hetimet, dhe Policia Gjyqësore në dispozicion të tij, e cila kryen çdo veprim hetimor që i është urdhëruar ose deleguar nga prokurori (neni 30/2 i KPP-së). Po në këtë drejtim, neni 33/1 i KPP-së sanksionon se seksionet e Policisë Gjyqësore varen nga drejtuesit e prokurorive të rretheve (shih paragrafin 21 të vendimit të shumicës). Gjithashtu, KPP-ja dhe ligjet organike të Prokurorisë dhe Policisë Gjyqësore përcaktojnë me hollësi dhe në mënyrë të qartë rregullat e ndjekjes penale, të hetimit dhe gjykimit, organet e ngarkuara për hetimet paraprake, sferën e kompetencës së secilit organ, si dhe raportin e vartësisë ndërmjet tyre, veçanërisht ndërmjet prokurorit dhe Policisë Gjyqësore (*shih paragrafin 24 të vendimit të shumicës*).

4. Në kuptim të sa më sipër, parashikimi me ligj i kompetencës për kryerjen e veprimeve hetimore nga ana e punonjësve të Byrosë së Hetimit, e cila nga dispozitat kushtetuese dhe ligjore u njihet subjekteve procedurale qartësisht të përcaktuara, bie ndesh me nenin 148/1 të Kushtetutës. Dhënia e një kompetence të tillë, në mungesë të përcaktimit të statusit të punonjësve të kësaj strukture dhe marrëdhënies së tyre të varësisë me organin e Prokurorisë, pavarësisht parashikimit të përgjithshëm në këtë ligj për zbatimin e legjislacionit penal dhe procedural penal, krijon paqartësi dhe dykuptimësi për zbatimin dhe ushtrimin në praktikë të kësaj veprimtarie nga ana e kësaj strukture.

¹ Gjyqtarja A. Xhoxhaj votoi vetëm për shfuqizimin e fjalës “hetimore” në nenin 27/2 dhe të fjalës “kryejnë hetime” në nenin 36/1 të ligjit nr. 108/2014.



5. Njohja e kësaj kompetence, një strukturë që organizohet brenda një pushteti tjetër, dhe për pasojë nuk ka asnjë marrëdhënie varësie dhe nuk i ushtrohet kontrollit të drejtpërdrejtë të organit të Prokurorisë, siç parashikohet specifikisht për veprimtarinë e Policisë Gjyqësore, në vlerësimin tim sjell probleme kushtetutshmërie. Ashtu siç përmend edhe shumica, neni 4 i ligjit nr. 8677/2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”, parashikon se në ushtrimin e detyrave dhe të funksioneve të saj Policia Gjyqësore është në varësi dhe drejtohet e kontrollohet nga prokurori. Ndërsa ligji nr. 8737/2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë” në nenin 56/a të tij përcakton marrëdhëniet e prokurorit me Policinë Gjyqësore, sipas të cilit prokurorët drejtojnë dhe kontrollojnë veprimtarinë hetimore të Policisë Gjyqësore dhe se prokurori ka të drejtë t’i japë urdhra dhe udhëzimet e duhura Policisë Gjyqësore (*shih paragrafin 22 të vendimit të shumicës*). Edhe në kuptim të këtyre dispozitave, veprimtaria hetimore nuk mund të ushtrohet në mënyrë të pavarur nga strukturat e Policisë së Shtetit, çilido qoftë emërtimi apo përbërja e këtyre strukturave.

6. Siç e përmenda edhe më sipër, në vlerësimin tim, ky ligj paraqet probleme kushtetutshmërie vetëm në këtë drejtim, pra vetëm në parashikimin e së drejtës së punonjësve të Byrosë së Hetimit për të ushtruar veprime hetimore, në mungesë të parashikimit të statusit të këtyre punonjësve të Policisë së Shtetit, çka lidhet drejtpërdrejt me pozicionin e tyre si subjekt procedural dhe për pasojë nënkupton edhe kategorinë e akteve që ata mund të prodhojnë, si edhe të parashikimit të varësisë së drejtpërdrejtë dhe kontrollit të kësaj veprimtarie (kupto hetimore) nga ana e Prokurorisë.

7. Eliminimi nëpërmjet shfuqizimit i këtyre fjalëve nga përmbajtja e neneve 27/2 dhe 36/1, të ligjit nr. 108/2014, në vlerësimin tim do të ishte i mjaftueshëm për të rikthyer gjendjen e kushtetutshmërisë dhe të ligjshmërisë. Për pasojë, argumentet e tjera të shumicës i gjej të sforuara dhe të pamjaftueshme në drejtim të argumentimit të jokushtetutshmërisë së dispozitave të tjera të ligjit që parashikojnë ngritjen e kësaj strukture dhe që rregullojnë mënyrën e zgjedhjes dhe të emërimit të punonjësve e drejtuesve të saj.

8. Byroja e Hetimit është ngritur si strukturë e veçantë e Policisë së Shtetit, që si objekt kryesor të saj ka veprimtarinë e gjurmimit për një kategori të caktuar veprash penale, konkretisht ato në fushën e korrupsionit dhe të veprimtarisë kriminale të lidhur me të. Në relacionin që ka shoqëruar projektligjin në Kuvend referohet se qëllimi i krijimit të saj është rritja e efektivitetit në luftën ndaj korrupsionit dhe krimit të organizuar. Sipas përkufizimeve të dhëna nga neni 6 i ligjit nr. 108/2014, “Veprimtari gjurmuese” është veprimtaria e punonjësve të Policisë së Shtetit e kryer në përputhje me legjislacionin në fuqi, për kërkimin, gjetjen, grumbullimin, administrimin, verifikimin, si dhe analizimin e të dhënave dhe informacioneve për veprimtari kriminale. Për sa kohë që shumica ka vlerësuar se kompetenca për të ushtruar veprimtari hetimore nuk mund të ushtrohet nga kjo strukturë, atëherë fusha e veprimtarisë së saj mbetet vetëm ajo që lidhet me veprimet gjurmuese, çka përputhet edhe me kompetencat dhe detyrat që ushtrojnë organet dhe strukturat e Policisë së Shtetit. Duhet të kihet parasysh këtu edhe fakti se brenda Policisë së Shtetit kanë vepruar gjithmonë struktura të veçanta, që, pavarësisht emërimit të tyre, kanë një fushë të caktuar veprimtarie, duke pasur për objekt një kategori të caktuar veprash penale.

9. Po ashtu e pavend më duket edhe analogjia me rastin e emërimit të administratës gjyqësore (*vendimi nr. 10, datë 6.3.2014 i Gjykatës Kushtetuese*) për sa i përket kompetencës së ministrit të Brendshëm për të përcaktuar me akte nënligjore organizimin dhe funksionimin e Byrosë Kombëtare të Hetimit. Sipas shumicës, fakti që emërimi, lirimi nga detyra dhe shkarkimi i drejtuesit të Byrosë Kombëtare të Hetimit është në kompetencë të ministrit të Punëve të Brendshme krijon premisa varësie të këtij organi nga pushteti ekzekutiv. Më tej, ajo shprehet se kjo varësi do të nënkuptonte edhe një influencë/ndërhyrje të pushtetit ekzekutiv në fazën fillestare të ndjekjes penale, atë të hetimeve paraprake, çka do të ndikonte në krijimin e raporteve të pabalancuara ndërmjet pushtetit ekzekutiv, nga njëra anë, dhe organit të Prokurorisë, nga ana tjetër (tagër ekskluziv i të cilit është ndjekja penale).

10. Së pari, në rastin e përmendur të administratës gjyqësore gjendemi para dy



pushteteve të ndryshme, pra atij gjyqësor dhe atij ekzekutiv, dhe për këtë arsye Gjykata ka vlerësuar se emërimi i administratës gjyqësore, pjesë e pushtetit gjyqësor, nga ana e ministrit të Drejtësisë, pjesë e pushtetit ekzekutiv, përbën cenim të neneve 7 dhe 145 të Kushtetutës. Në rastin në fjalë jemi përpara një strukture që organizohet, funksionon dhe është pjesë e pushtetit ekzekutiv dhe për pasojë rregullimi dhe mënyra e emërimit të punonjësve të saj nuk mund të bëhet veçse në mënyrë hierarkike brenda vetë këtij sistemi.

11. Së dyti, vetë shumica ka pranuar se për shkak të varësisë që ka nga pushteti ekzekutiv dhe mungesës së parashikimit të varësisë nga prokurori, kompetencat hetimore që i janë dhënë kësaj strukture janë të papajtueshme me rregullimet kushtetuese. Për pasojë, nëse nuk kërkohet garantimi i pavarësisë së kësaj strukture, për shkak të kompetencave të njohura nga ligji, është e pavend që të shkohet më tej dhe të analizohen elemente të tilla pavarësie për të cilat më sipër shumica ka konkluduar se ky organ nuk mund t'i gëzojë.

12. Në përfundim të sa më sipër vlerësoj se në rastin konkret nuk kishte vend për pranimin tërësisht të kërkesës dhe shfuqizimin e të gjithë kreut VI, të ligjit nr. 108/2014, “Për Policinë e Shtetit”.

Anëtare: Altina Xhoxhaj

MENDIM PAKICE

1. Për arsye se nuk ndajmë të njëjtin qëndrim me shumicën lidhur me përfundimin e arritur në këtë çështje dhe argumentet mbi të cilat mbështetet ky qëndrim, e çmojmë të rëndësishme të shprehemi me mendim pakice.

2. Nëpërmjet arsytimit të saj shumica ka vlerësuar se “mungesa në ligjin objekt shqyrtimi e rregullimeve që përcaktojnë raportet procedurale midis Byrosë Kombëtare të Hetimit (BKH) dhe organit të Prokurorisë, si dhe pozitën e këtij organi në raport me Policinë Gjyqësore, mospërcaktimi i saktë dhe i hollësishëm jo vetëm i kompetencave, por edhe i sferës së veprimtarisë, e bëjnë atë të paplotë, të paqartë, duke krijuar probleme me zbatimin në praktikë të ligjit dhe në mënyrë të veçantë me efektivitetin e veprimtarisë së këtij organi (§ 30 i vendimit).

Parashikimi i vetëm se veprimtaria e Byrosë kryhet në përputhje me legjislacionin penal dhe procedural penal nuk është i mjaftueshëm për të sqaruar në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme raportin ndërmjet BKH-së dhe organit të Prokurorisë. Ai përbën thjesht një referim të përgjithshëm. Sfera e kompetencës së këtij subjekti, raportet e tij me organin e Prokurorisë, si dhe me organet e gjurmimit dhe të hetimit duhet të përcaktohen në mënyrë të saktë duke iu referuar dispozitave të KPP-së, si ligji bazë që përcakton rregullat për mënyrën e ushtrimit të ndjekjes penale, të hetimit dhe të gjyqimit (neni 2 i KPP-së) (§ 31 i vendimit). Për rrjedhojë, parashikimet ligjore të kreut VI, të ligjit nr. 108/2014, jo vetëm që nuk sjellin përmirësim në fushën e hetimit të veprave penale kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, por ofrojnë disa zgjidhje që shkojnë në kundërshtim me qëllimin që synon ligjvënësi, sepse bien ndesh me parimet kushtetuese, dhe si të tilla mund të çojnë në cenimin e shtetit të së drejtës dhe të drejtave dhe lirive të individit” (§ 35 i vendimit). Si konkluzion, duke u mbështetur në arsyetimin e mësipërm, shumica ka çmuar se parashikimet e kreut VI të ligjit nr. 108/2014 bien ndesh me parimin e shtetit të së drejtës dhe parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve për shkak të mungesës së harmonizimit të kompetencave të saj me dispozitat përkatëse të KPP-së për hetimin e veprave penale, si dhe të mospërcaktimit të raporteve procedurale të kësaj strukture me Prokurorinë dhe subjektet e tjera të hetimit (§ 40 i vendimit). Nuk pajtohem me këtë qëndrim të shumicës për arsyet që paraqiten në vijim.

3. Gjykata ka çmuar në jurisprudencën e saj se Kuvendi si organ ligjvënës ka të drejtë të zbatojë ose konkretizojë politika të caktuara për përmirësimin e qeverisjes dhe zhvillimin e vendit në tërësi, ose t'u përgjigjet prioriteve apo problemeve të ndryshme të vendit. Megjithatë, ligjet apo dispozita të veçanta të tyre, të miratuara nga ligjvënësi për këtë qëllim, nuk duhet të vijnë në kundërshtim me dispozitat e Kushtetutës (*shih vendimin nr. 29, datë 31.5.2010 të Gjykatës Kushtetuese*). Nuk është në funksionin e Gjykatës Kushtetuese të kontrollojë synimet, objektivat dhe efektivitetin e zgjedhjeve legjislative të zbatuara nga ana e ligjvënësit. Detyrë e kësaj Gjykate është të vlerësojë nëse këto rregullime



legjislative respektojnë parimet, standardet dhe rregullat e Kushtetutës (*shih vendimin nr. 16, datë 25.7.2008 të Gjykatës Kushtetuese*).

4. Në vlerësimin e kushtetutshmërisë së ligjeve, kjo Gjykatë niset nga prezumimi i pajtueshmërisë së tyre me Kushtetutën. Kjo do të thotë se lidhur me jokushtetutshmërinë e pretenduar duhet të parashtrihen argumente bindëse për t'i dhënë mundësi Gjykatës Kushtetuese të vlerësojë nëse zgjidhjet ligjore të aplikuara shkelin normat dhe vlerat kushtetuese (*shih vendimet nr. 37, datë 13.6.2012 ; nr. 29, datë 31.5.2010; nr. 16, datë 25.7.2008 të Gjykatës Kushtetuese*).

5. Ligji nr. 108/2014 objekt shqyrtimi, ka krijuar BKH-në si strukturë të veçantë të Policisë së Shtetit, që kryen veprimtari gjurmuese dhe hetimore, në përputhje me legjislacionin penal dhe procedural penal, për veprat penale në fushën e korrupsionit dhe të veprimtarisë kriminale të lidhur me të (neni 27). Sipas shumicës ky është një referim i përgjithshëm në Kodin e Procedurës Penale, jo i mjaftueshëm për të sqaruar në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme raportin ndërmjet BKH-së dhe organit të Prokurorisë. Ndryshe nga shumica vlerësojmë se çështja konkrete duhet trajtuar në një këndvështrim më të gjerë, duke pasur parasysh standardet e vendosura nga Gjykata të prezumimit të ligjit si kushtetues dhe interpretimit të tij, për aq sa është e mundur, në pajtim me Kushtetutën.

6. Kështu, ligji nr. 108/2014 duhet parë i pandarë dhe duhet lexuar së bashku me ligje të tjera që rregullojnë kryerjen e veprimtarisë hetimore në fushën penale, konkretisht KPP-në dhe ligjin nr. 8677, datë 2.11.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”, i ndryshuar (ligji “Për Policinë Gjyqësore”). Referenca që përmban neni 27 i ligjit nr. 108/2014 nënkupton se veprimtaria gjurmuese dhe hetimore që do të kryejë Byroja Kombëtare e Hetimit do të jetë në përputhje me legjislacionin penal dhe atë procedural penal. Sipas nenit 24 të KPP-së: “Prokurori ushtron ndjekjen penale, bën hetime, kontrollon hetimet paraprake, ngre akuzë në gjykatë dhe merr masa për ekzekutimin e vendimeve në përputhje me rregullat e caktuara në këtë Kod. Prokurori ka të drejtë të mos fillojë ose të pushojë procedimin

penal në rastet e parashikuara në këtë Kod”. Duke i interpretuar së bashku këto nene arrihet në konkluzionin se të gjitha veprimet e kryera nga BKH-ja duhet të respektojnë procedurat hetimore dhe të kontrollohen nga prokurori. Pra është prokuroria ajo që vlerëson nëse materialet hetimore të mbledhura nga BKH-ja plotësojnë kërkesat e ligjit material penal dhe janë administruar konform ligjit procedural penal, si dhe vendos për fillimin ose jo të procedimit penal. Kur prokuroria konstaton nga materiali paraprak hetimor i ardhur nga BKH-ja se ekzistojnë elemente të veprës penale, vendos fillimin e procedimit penal dhe urdhëron kryerjen e veprimeve të nevojshme procedurale, të parashikuara në legjislacionin procedural penal. Duke parashikuar si kufij ligjorë kryerjen e veprimtarisë së BKH-së në përputhje me legjislacionin penal dhe atë procedural penal, ligjvënësi ka garantuar kompetencat e prokurorit si organ i ndjekjes penale. Realizimi i veprimeve hetimore nga BKH-ja për veprat penale të korrupsionit nuk e shmang rolin e prokurorit në ushtrimin e ndjekjes penale, si dhe në hetimin dhe kontrollin e hetimeve paraprake, të cilat janë kompetenca ekskluzive të tij. Prokurori mbikëqyr dhe kontrollon veprimtarinë hetimore të BKH-së në rastet e hetimit të veprave penale të korrupsionit, njësoj si kontrollon dhe drejton hetimin e kryer nga Policia e Shtetit dhe Policia Gjyqësore për vepra të tjera penale.

7. Gjithashtu, në aspektin organizativ, BKH-ja funksionon si një strukturë e veçantë e Policisë së Shtetit. Veprimtaria e policisë është e lidhur ngushtë me zbulimin e veprimeve kriminale dhe kryhet në përputhje me dispozitat e KPP-së dhe ligjin “Për Policinë Gjyqësore”. Policia kryen veprimtari gjurmuese për kërkimin, gjetjen, grumbullimin, administrimin, verifikimin dhe analizimin e të dhënave për veprimtari kriminale dhe veprimtari hetimore në përputhje me KPP-në (pikat 28 dhe 29, të nenit 6, të ligjit nr. 108/2014). Të gjitha këto informacione për ekzistencën e veprës penale që sigurohen nga Policia e Shtetit i dërgohen prokurorit që drejton hetimet. Si pjesë e Policisë së Shtetit, BKH-ja është parashikuar të kryejë veprimtari gjurmuese dhe hetimore në kuadrin e hetimit të veprave penale, të korrupsionit dhe veprimtarisë kriminale të lidhur me të. Në vështrim të neneve



18, 27, 31 dhe 36 të ligjit nr. 108/2014, BKH-ja e ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me ligjin “Për Policinë e Shtetit” (nr. 108/2014), dispozitat e KPP-së dhe ligjin “Për Policinë Gjyqësore”. Nga interpretimi sistematik i këtyre neneve është e qartë se ligji nr. 108/2014 ka përcaktuar një raport llogaridhënieje të BKH-së përpara drejtorit të Policisë së Shtetit, në lidhje me veprimtarinë gjurmuese të saj, dhe përpara prokurorit, për sa i përket veprimtarisë hetimore procedurale. Po kështu roli i ministrit të Brendshëm në raport me BKH-në ka të bëjë me aspektet strukturore, organizative dhe administrative të saj, duke përjashtuar llogaridhënien e kësaj strukture përpara ministrit në lidhje me ushtrimin e veprimtarisë dhe të kompetencave të saj.

8. Për sa u përket kompetencave, në bazë të nenit 36 të ligjit nr. 108/2014, punonjësit e Byrosë, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me iniciativën e tyre, duhet të marrin dënim për veprat penale në fushën e korrupsionit dhe vepra të tjera të lidhura me to, të pengojnë ardhjen e pasojave të mëtejshme, të kërkojnë autorët e tyre, të mbledhin dhe të administrojnë çdo të dhënë të ligjshme, si dhe të kryejnë hetime që i shërbejnë zbatimit të ligjit penal. Nga përmbajtja e kësaj dispozite rezulton se ligji nuk i heq të drejtën prokurorit për ushtrimin e ndjekjes penale dhe përfaqësimin e akuzës në gjykatë, por e ndihmon në sigurimin e të dhënave dhe informacionit të nevojshëm për hetimin e veprave penale të korrupsionit, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Konkretisht, sipas nenit 277 të KPP-së “*prokurori dhe Policia Gjyqësore zhvillojnë, brenda kompetencave të caktuara, hetimet e nevojshme që lidhen me ushtrimin e ndjekjes penale*”. Policia Gjyqësore kryen veprimtari procedurale përgjatë të gjitha fazave të procedimit penal, të urdhëruar apo deleguar nga organi procedues ose me nismën e vet, sipas rregullave të legjislacionit procedural në fuqi (neni 2/2 i ligjit “Për Policinë Gjyqësore”). Çdo punonjës i policisë gëzon atributet e Policisë Gjyqësore në përputhje me legjislacionin procedural penal dhe ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore” (neni 18 i ligjit nr. 108/2014). Veprimtaria gjurmuese dhe hetimore që zhvillon BKH-ja, sipas neneve 27 dhe 36 të ligjit nr. 108/2014, është e njëjtë me veprimtarinë që kryen Policia Gjyqësore sipas nenit 3, të ligjit “Për

Policinë Gjyqësore”. Kompetencat e BKH-së për mbledhjen dhe administrimin e të dhënave, si dhe kryerjen e hetimeve që i shërbejnë zbatimit të ligjit penal për veprat e korrupsionit janë të njëjta me kompetencat që i përkasin Policisë Gjyqësore, si pjesë e Policisë së Shtetit, të parashikuara në nenet 30 dhe 294 të KPP-së. Veprat penale në fushën e korrupsionit (si aktiv, ashtu edhe pasiv) janë parashikuar si dispozita të veçanta në Kodin Penal. Në ushtrimin e detyrave dhe të funksioneve të saj, Policia Gjyqësore kontrollon nga prokurori (neni 4 i ligjit “Për Policinë Gjyqësore”). Në vështrim të këtyre dispozitave rezulton se BKH-ja, në përbërje të së cilës përfshihet edhe Policia Gjyqësore, ushtron kompetencat hetimore në respektim të legjislacionit në fuqi në fushën e hetimeve penale. Gjithashtu, theksojmë se përveç BKH-së ka edhe institucione të tjera shtetërore që kryejnë veprimtari hetimore me iniciativën e tyre. Kështu, Shërbimi për Ankesat dhe Çështjet e Brendshme (ish-SHKB-ja) ka si objekt të veprimtarisë, ndër të tjera, edhe parandalimin, zbulimin dhe hetimin e veprave penale, si dhe të shkeljeve të ligjit, të kryera nga punonjësit e strukturave përkatëse gjatë ushtrimit të detyrës dhe për shkak të saj (*shih ligjin nr. 70/2014, datë 10.7.2014, “Për shërbimin për çështjet e brendshme dhe ankesat në Ministrinë e Punëve të Brendshme”*). Institucione të tjera si Antikontrabanda, Drejtoria Hetimore e Tatimeve, Roja Bregdetare, Shërbimi Pyjor, përveç detyrave të tyre funksionale, kryejnë hetim dhe nëse konstatojnë se çështja i kalon kufijtë administrativë bëjnë denoncimet përkatëse në prokurori (*shih ligjet nr. 9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, i ndryshuar; nr. 8875, datë 4.4.2002, “Për Rojën Bregdetare Shqiptare”, i ndryshuar; nr. 102/2014, datë 31.7.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe aktet nënligjore për zbatimin e tij, si dhe VKM-në nr. 400, datë 22.4.2009 “Për përcaktimin e detyrave dhe të funksioneve të Drejtorisë së Hetimit Tatimor”*). Megjithatë në të gjitha këto raste, duke përfshirë edhe hetimin e zhvilluar nga BKH-ja, veprimet hetimore i nënshtrohen kontrollit të prokurorit, i cili është përgjegjës për ndjekjen penale.

9. Nisur nga sa më sipër, duke pasur parasysh jurisprudencën e Gjykatës, e cila ka vënë theksin në prezumimin e ligjit si kushtetues dhe interpretimin e tij, për aq sa është e mundur, në pajtim me Kushtetutën, vlerësojmë se mosparashikimi në mënyrë specifike nga



ligjvënësi i raporteve procedurale të BKH-së me Prokurorinë e subjektet e tjera të hetimit dhe referencat e përgjithshme në KPP, të përdorura prej tij në ligj, nuk janë të tilla që e bëjnë ligjin antikushtetues. Ligjvënësi është përgjegjës për hartimin e legjislacionit, në rastin konkret, dhe për marrjen e tërësisë së masave që synojnë të parandalojnë dhe luftojnë krimin e korrupsionit në kontekstin aktual. Në këtë drejtim ligjvënësit i njihen hapësira për zgjidhje diskrecionale që i rezervohen vetëm atij. Detyrë e Gjykatës, siç është thënë më lart, është të vlerësojë nëse këto rregullime legjislative respektojnë parimet, standardet dhe rregullat e Kushtetutës.

10. Për më tepër nëse shumica, në rastin në shqyrtim, nuk do të shfuqizonte dispozitat ligjore konkrete, por do të përpiquej të bënte një interpretim pajtues të ligjit, zbatimi i vendimit të saj do të ishte i detyrueshëm duke evituar paqartësitë dhe problemet e mundshme gjatë zbatimit në praktikë të ligjit. Nenet 124 dhe 132 të Kushtetutës shprehën qartësisht në lidhje me forcën detyruese të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese mbi të gjitha organet kushtetuese, autoritetet publike, duke përfshirë edhe gjykatat. Zbatimi i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese është detyrim kushtetues; ato kanë fuqi detyruese të përgjithshme dhe janë përfundimtare. Si të tilla, përbëjnë jurisprudencë kushtetuese dhe, për rrjedhojë, kanë efektet e forcës së ligjit. Ky efekt detyrues ka të bëjë si me pjesën urdhëruese, ashtu edhe me pjesën arsyetuese të vendimit (*shih vendimet nr. 21, datë 29.4.2010; nr. 14, datë 3.6.2009; nr. 5, datë 7.2.2001 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Për arsyet e mësipërme vlerësojmë se kërkesa për shfuqizimin si antikushtetues të ligjit objekt shqyrtimi, mbështetur në pretendimet për cenimin e parimit të shtetit të së drejtës dhe të parimit të ndarjes dhe të balancimit të pushteteve për shkak të mungesës së harmonizimit të kompetencave të BKH-së me dispozitat përkatëse të KPP-së për hetimin e veprave penale, si dhe të mospërcaktimit të raporteve procedurale të kësaj strukture me Prokurorinë dhe subjektet e tjera të hetimit, është e pabazuar dhe, për rrjedhojë shumica duhej të vendoste rrëzimin e kërkesës.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Sokol Berberi

VENDIM

Nr. 44, datë 29.6.2015

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“
Sokol Berberi	anëtar i	“	“
Vitore Tusha	anëtare e	“	“
Altina Xhoxhaj	anëtare e	“	“
Gani Dizdari	anëtar i	“	“
Besnik Imeraj	anëtar i	“	“
Fatos Lulo	anëtar i	“	“

me sekretare Edmira Babaj, në datën 9.4.2015 mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 17 Akti, që i përket:

KËRKUES: Edlira Nuredinaj

SUBJEKTI I INTERESUAR: Kristo Kamberaj

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i vendimit nr. 00-2014-2555, datë 1.10.2014 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 41/1, 42/1, 43, 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe nenet 7, 10, 13, 14, 16, 28, 29 të Kodit të Procedurës Civile.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Fatos Lulo, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkeses, që është shprehur për pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar, që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kërkesja dhe subjekti i interesuar kanë qenë të martuar nga viti 1997 deri në vitin 2009, kur Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. 271, datë 5.2.2009, ka vendosur zgjidhjen e martesës. Kërkesja i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë për pjesëtimin e pasurisë së përbashkët, kërkesë e cila është pranuar me vendimin e fazës së parë të pjesëtimit nr. 1755 regj., datë 7.9.2009 të



Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, që ka vendosur: “[...] *lejimin e pjesëtimit të pasurisë së vënë gjatë martesës, duke caktuar në pjesë të barabarta nga 1/2 secili mbi sendet që përfaqësojnë: (1) një apartament me sipërfaqe 251.6 m²; (2) një objekt banesë trekatëshe me sipërfaqe 140 m², kati i parë dyqan [...]*”.

2. Mbi ankimin e paraqitur nga subjekti i interesuar, Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. 95, datë 23.4.2010, ka vendosur *ndryshimin e vendimit të fazës së parë të pjesëtimit të pasurisë së përbashkët dhe, duke e gjykuar çështjen në fakt, ka rrëzuar padinë e kërkuarës.*

3. Kërkuesja ka depozituar rekurs në Gjykatën e Lartë, e cila, me vendimin nr. 00-2012-2245, datë 1.11.2012, *ka vendosur mospranimin e rekursit në dhomë këshillimi.*

4. Kërkuesja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese, e cila, me vendimin nr. 42, datë 7.7.2014, ka vendosur *pranimin pjesërisht të kërkesës, shfuqizimin si të papajtuësëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimit nr. 00-2012-2245, datë 1.11.2012 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në këtë gjykatë.*

5. Gjykata e Lartë në rishqyrtimin e çështjes, me vendimin nr. 00-2014-2555, datë 1.10.2014, ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuesja kundër vendimit nr. 95, datë 23.4.2010, të Gjykatës së Apelit Vlorë.

II

6. **Kërkuesja** i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese, duke pretenduar cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor gjatë rishqyrtimit të çështjes në Gjykatën e Lartë, në këto drejtime:

6.1. Është cenuar *parimi i paanshmërisë*, pasi Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka favorizuar palën tjetër në gjykim.

6.2. Është cenuar *standardi kushtetues i arsyetimit të vendimeve*, pasi Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë nuk ka marrë në konsideratë vendimin e Gjykatës Kushtetuese në lidhje me arsyetimin e shkaqeve të paraqitura në rekurs.

6.3. Është shkelur *e drejta e aksesit*, pasi Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, duke qenë se kjo çështje u kthye për rishqyrtim nga Gjykata Kushtetuese, duhej ta shqyrtonte çështjen në seancë gjyqësore.

7. **Subjekti i interesuar**, Kristo Kamberaj, në pretendimet parashtuar Gjykatës, ka prapësuar se të gjitha pretendimet e ngritura nga kërkuesja

janë shqyrtuar edhe më parë nga Gjykata Kushtetuese dhe në kuptimin procedural dhe kushtetues përbëjnë “gjë të gjykuar”. Sipas tij i vetmi shkak për të cilin Gjykata Kushtetuese vendosi shfuqizimin e vendimit nr. 00-2012-2245, datë 1.11.2012 të Gjykatës së Lartë, lidhet me qëndrimin se pretendimeve me natyrë kushtetuese duhet t’u jepej përgjigje nga Gjykata e Lartë (GJL-ja). Siç rezulton nga vendimi i GJL-së, kjo e fundit e ka përmbushur këtë detyrim, duke u shprehur se “[...] *nuk konstaton mosrespektimin e ligjit ose zbatimin e gabuar të ligjit material e procedural [...]*”.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuarës

8. Gjykata vlerëson se kërkuesja legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës, dhe *ratione temporis*, pasi kërkesa është paraqitur në Gjykatën Kushtetuese brenda afatit të parashikuar nga ligji. Në kuptim të nenit 30 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, individit, pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e të drejtave të tij, mund ta paraqesë kërkesën në Gjykatën Kushtetuese brenda 2 vjetëve nga data e njoftimit të vendimit të fundit të organit përkatës shtetëror. Në rastin në shqyrtim, vendimi më i fundit në kohë është vendimi nr. 00-2014-2555, datë 1.10.2014 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (*dhomë këshillimi*).

9. Në lidhje me legjitimitimin *ratione materiae*, Gjykata paraprakisht konstaton se pretendimet e kërkuarës lidhur me respektimin e elementeve të procesit të rregullt ligjor, si: e drejta e aksesit, parimi i paanshmërisë dhe standardi kushtetues i arsyetimit të vendimit gjyqësor, janë parashtruar dhe i janë nënshtruar edhe më parë gjykimit kushtetues. Në këto kushte Gjykata çmon se kërkuesja nuk legjitimohet për atë pjesë të pretendimeve të cilat kanë marrë përgjigje në vendimin nr. 42, datë 7.7.2014. Në vijim, Gjykata merr në analizë këto pretendime.

B. Për cenimin e parimit të paanshmërisë

10. Kërkuesja ka pretenduar se Gjykata e Lartë ka favorizuar palën tjetër në gjykim, duke cenuar parimin e gjykimit nga një gjykatë e



paanshme. Nga ana e Kolegjit Civil të kësaj gjykate nuk është marrë në konsideratë fakti se deklarata noteriale nr. 60 rep., nr. 1053 kol., datë 21.7.2008 mbi heqjen dorë në mënyrë të njëanshme nga pronësia (e administruar në gjykimin e zakonshëm) është bërë nga kërkuesja në kushtet e dhunës dhe të presionit psikologjik.

11. Meqenëse ky pretendim është vlerësuar edhe më parë nga Gjykata, dhe në kushtet kur kërkuesja nuk ka sjellë asnjë argument të ri në mbështetje të tij, Gjykata çmon t'i përmbahet qëndrimit të saj të shprehur në vendimin nr. 42, datë 7.7.2014. Konkretisht në këtë vendim Gjykata ka konstatuar se *"[...]kërkuesja nuk parashtrohet argumente kushtetuese në lidhje me mungesën e garancive procedurale të mjaftueshme nga gjykatat dhe në lidhje me qëndrimin subjektiv të gjyqtarëve në atë proces"*. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkueses për cenimin e një prej elementeve të së drejtës për një proces të rregullt gjyqësor, që lidhet me besueshmërinë e gjykatës për të qenë objektivisht e paanshme në perceptimin e publikut, nuk është ngritur në nivel kushtetues".

C. Për cenimin e standardit kushtetues të arsyetimit të vendimit dhe të drejtën e aksesit në Gjykatën e Lartë

12. Kërkuesja ka pretenduar se Gjykata e Lartë nuk ka marrë parasysh pretendimet në lidhje me shkeljet e ligjit procedural dhe material të Gjykatës së Apelit, si dhe nuk ka arsyetuar shkaqet e ngritura në rekurs, duke shkelur parimin e arsyetimit të vendimit. Për këtë arsye, të theksuar edhe nga Gjykata Kushtetuese në vendimin e saj nr. 42, datë 7.7.2014, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë duhej ta kalonte çështjen në seancë plenare.

13. Në vendimin nr. 42, datë 7.7.2014, Gjykata ka mbajtur këtë qëndrim: *"Në rastin në gjykim, nisur nga detyrimi që ka Gjykata e Lartë që rast pas rasti t'u japë përgjigje problemeve ligjore që në praktikë lidhen me interpretimin e ligjit material, po edhe për shkak të natyrës së të drejtës së pretenduar, siç është e drejta e pronësisë, Gjykata vlerëson se për sa kohë kërkuesja nuk ka marrë përgjigje për pretendimet me natyrë kushtetuese të parashtuara në rekurs, asaj i është mohuar e drejta e aksesit në kuptimin substancial, në këtë kuptim pretendimi për cenimin e kësaj të drejte nga Gjykata e Lartë është i bazuar dhe duhet pranuar."*

14. Gjykata rithekson se zbatimi i detyrueshëm i vendimeve të saj është i garantuar nga Kushtetuta, e cila në nenet 132 dhe 145 të saj

sanksionon shprehimisht këtë koncept kushtetues. Vendimet e Gjykatës kanë fuqi detyruese të përgjithshme dhe janë përfundimtare. Ato përbëjnë jurisprudencë kushtetuese dhe, për rrjedhojë, kanë efektet e forcës së ligjit. Ky efekt detyrues ka të bëjë si me pjesën urdhëruese, ashtu edhe me pjesën arsyetuese të vendimit. Në respekt të doktrinës dhe të jurisprudencës kushtetuese, Gjykata ka theksuar se efekti detyrues që pasqyrohet mbi argumentet thelbësore të vendimit të saj përbëjnë edhe një *ratio decidendi*, eliminimi i të cilave do ta bënte vendimin, në tërësinë e tij, të pakuptimtë. Nga kjo pikëpamje Gjykata ka theksuar se nga standardi i detyrimit të zbatimit të vendimarrjes kushtetuese nuk mund të bëjë përjashtim as vet Gjykata Kushtetuese (*shih vendimet nr. 5, datë 7.2.2001; nr. 14, datë 3.6.2009; nr. 21, datë 29.4.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Në rastin konkret, siç rezulton nga përmbajtja e vendimit nr. 00-2014-2555, datë 1.10.2014 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, çështja është shqyrtuar në dhomën e këshillimit, duke vendosur mospranimin e rekursit. Për nga vetë natyra seleksionuese e dhomës së këshillimit është i pranuar fakti se vendimet që finalizojnë këto gjykime kanë një arsyetim të kufizuar, megjithatë jo në çdo rast ky arsyetim mund të përmbush kriteret përcaktuese të procesit të rregullt ligjor, veçanërisht kur në rekurs ngrihen pretendime me natyrë kushtetuese. Nëse më parë GJK-ja ka vlerësuar (*shih më lart vendimin nr. 42/2014*) se kërkueses i është cenuar e drejta e aksesit në kuptimin substancial nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, Gjykata çmon se edhe rigjykimi i çështjes në dhomë këshillimi nuk ia ka garantuar kërkueses këtë të drejtë (kupto: *e drejta e aksesit*).

16. Për rrjedhojë, Gjykata arrin në përfundimin se Gjykata e Lartë nuk i ka përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimet që rrjedhin nga vendimi nr. 42, datë 7.7.2014 për të zhvilluar një proces të rregullt ligjor gjatë rigjykimit të çështjes në po atë gjykatë. Në këto kushte, duke mbajtur në konsideratë edhe efektin detyrues të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, të shtjelluar më lart, Gjykata çmon se pretendimi i kërkueses për cenimin e së drejtës së aksesit është i bazuar dhe se vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë duhet të shfuqizohet.



17. Gjykata vë në dukje faktin se shqyrtimi gjyqësor i çështjeve në mënyrë të përsëritur çon në kohëzgjatje të paarsyeshme të procesit gjyqësor, madje duke krijuar një precedent i cili ka premisë të ndikojë edhe në efektivitetin e gjykimit kushtetues. Në këtë kuptim, Gjykata vëren se parregullsitë e konstatuara prej saj në lidhje me respektimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor nga gjykatat e zakonshme, duhet të korrigjohen në rigjykimin e çështjes.

18. Si përfundim, Gjykata çmon se kërkesa duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, shkronja “f”, dhe 134, pika 1, shkronja “g”, të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 dhe 77 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Pranimin kërkesës.
- Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2014-2555, datë 1.10.2014 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.
- Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar), Vladimir Kristo, Gani Dizdari, Vitore Tusha, Besnik Imeraj

Anëtarë kundër: Sokol Berberi, Altina Xhoxhaj, Fatos Lulo

MENDIM PAKICE

1. Në çështjen me kërkuese Edlira Nuredinaj jam kundër qëndrimit të shumicës për pranimin e kërkesës, duke shfuqizuar vendimin nr. 00-2014-2555, datë 1.10.2014 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, dhe, për pasojë, dërgimin e çështjes për rishqyrtim në po atë gjykatë.

2. Kërkuessa i është drejtuar edhe më parë Gjykatës Kushtetuese për shfuqizimin e procesit gjyqësor ku ajo ka qenë palë, dhe me vendimin nr. 42, datë 7.7.2014 është vendosur pranimi

pjesërisht i kërkesës, shfuqizimi i vendimit nr. 00-2012-2245, datë 1.11.2012 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, dhe dërgimi i çështjes për rishqyrtim në po atë gjykatë. Në këtë vendim Gjykata ka vlerësuar: “Për sa kohë kërkuessa nuk ka marrë përgjigje për pretendimet me natyrë kushtetuese të parashtruara në rekurs, asaj i është mohuar e drejta e aksesit në kuptimin substancial, dhe, në këtë kuptim, pretendimi për cenimin e kësaj të drejte nga Gjykata e Lartë është i bazuar dhe duhet pranuar” (shih paragrafët 15-19 të vendimit nr. 42/2014).

3. Në këtë çështje kam qenë kundër vendimit të shumicës, duke argumentuar, bazuar në jurisprudencën e Gjykatës, se në rastet kur nuk konstatohet cenimi i së drejtës për proces të rregullt ligjor në procesin gjyqësor të zhvilluar në të tria shkallët e gjykimit, nuk mund të vihet në dyshim procesi i zhvilluar në Gjykatën e Lartë, duke u mbështetur thjesht në faktin se është vendosur mospranimi i rekursit në dhomë këshillimi. Po ashtu, vlerësimi im në atë çështje ka qenë se në rastet kur ka interpretime të ndryshme të ligjit nga gjykatat e zakonshme, kjo nuk nënkupton që Gjykata e Lartë ka detyrimin të shprehet lidhur me mënyrën se si ai ligj i zbatueshëm duhet të interpretohet. Edhe pse rekursat shqyrtohen në dhomë këshillimi, shqyrtimi i tyre nuk është vetëm një konstatim formal i paraqitjes së shkaqeve ligjore në rekurs, por konsiston në vlerësimin e këtyre shkaqeve dhe bazueshmërisë së tyre, duke analizuar materialet e dosjes gjyqësore. Në rastet kur Kolegji i Gjykatës së Lartë konstaton se shkaqet, pavarësisht nga mënyra e paraqitjes së tyre, kanë të bëjnë me vlerësimin e provave e bindjen e brendshme të gjykatave të shkallëve më të ulëta apo me pretendime që objektivisht nuk ekzistojnë në dosjen gjyqësore, ka të drejtë të mos e pranojë rekursin. Po ashtu, nëse Kolegji i Gjykatës së Lartë arrin në përfundimin se interpretimi që ka bërë gjykata e apelit, i cili është ai që kundërshtohet në rekurs, është i drejtë, është në kompetencën e tij të vendosë mospranimin e rekursit. Kjo është edhe përgjigja që u jep Gjykata e Lartë pretendimeve të ngritura në rekurs nga palët.

4. Në të njëjtën linjë me sa më sipër, vlerësoj se kërkesa e re e paraqitur nga kërkuessa nuk duhej të pranohej për të njëjtat arsye të shprehura në mendimin e mëparshëm në pakicë. Gjykata e Lartë, duke respektuar fuqinë detyruese të vendimit të Gjykatës Kushtetuese, e ka marrë



sërish në shqyrtim këtë çështje, me një përbërje të ndryshme të Kolegjit Civil, duke vlerësuar shkaqet e paraqitura në rekurs nga ana e kërkuësës. Asnjë dispozitë ligjore nuk e detyron Gjykatën e Lartë që në raste të tilla ta shqyrtojë çështjen në seancë gjyqësore. Jo vetëm kaq, por Gjykata Kushtetuese nuk ka gjetur cenim të së drejtës së aksesit në një rast të shqyrtuar prej saj ku edhe pse ka prishur një vendim të seancës gjyqësore dhe e ka kthyer çështjen për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë, kjo e fundit ka vendosur mospranimin e rekursit tashmë në dhomë këshillimi, edhe pse shkaqet e rekursit ishin vlerësuar më parë prej saj se ishin të tilla që duhej të shqyrtoheshin në seancë gjyqësore. Në këtë çështje Gjykata ka vlerësuar se nuk është cenuar e drejta e aksesit, për sa kohë që pas kthimit të çështjes në Gjykatën e Lartë, pretendimet e paraqitura në rekurs janë marrë në shqyrtim në dhomën e këshillimit dhe u është dhënë përgjigje se nuk janë të tilla nga ato që parashikon dispozita përkatëse procedurale (*shih vendimin nr. 52, datë 14.11.2014, me kërkuese Aurora Topçu*).

5. Duke i qëndruar mendimit tim të shprehur më parë në disa çështje të kësaj natyre, dua të ritheksoj se vlerësimi i shkaqeve ligjore të paraqitura në rekurs është kompetencë e dhomës së këshillimit dhe nuk mund të bëhet kurrësi objekt i vlerësimit nga ana e Gjykatës Kushtetuese. Në këtë kuptim, çështjet e ngritura në rekurs nga kërkuësja janë të tilla që kanë të bëjnë me mënyrën e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit nga gjykatat më të ulëta dhe i vetmi organ që ka kompetencën për t'u shprehur lidhur me to, është Gjykata e Lartë, çka ajo e ka bërë në rastin konkret nëpërmjet vendimit të dhënë në dhomën e këshillimit. Për sa kohë Gjykata e Lartë ka vendosur sërish mospranimin e rekursit, kjo do të thotë se shkaqet e ngritura në të nga kërkuësja, që janë paraqitur si shkaqe ligjore për prishjen e vendimit të gjykatës së apelit, nuk gjejnë mbështetje as në ligj, as në materialet e çështjes. Nëse Gjykata Kushtetuese nuk identifikon cila është shkelja e kryer nga gjykatat më të ulëta, edhe duke e kthyer çështjen në atë gjykatë, nëse është e nevojshme, ajo nuk mund të mjaftohet me faktin se rekursi është shqyrtuar në dhomë këshillimi. Një qëndrim i tillë i Gjykatës vë në dyshim dhe nuk qartëson standardet që duhet të ndjekë Gjykata e Lartë në ushtrimin e kompetencës së saj për shqyrtimin paraprak të rekurseve në

dhomë këshillimi. Nuk është e qartë në të tilla qëndrime nëse Gjykata e Lartë duhet të kalojë për shqyrtim në seancë gjyqësore çdo çështje që ngre formalisht probleme kushtetuese dhe ligjore apo nëse duhet të arsyetojë çdo vendim të dhomës së këshillimit, ndërkohë që tashmë ka një standard arsyetimi të këtyre lloj vendimesh, i cili edhe nga GJEDNJ-ja nuk është gjetur në kundërshtim me standardet e KEDNJ-së. Të tilla qëndrime formale të Gjykatës Kushtetuese, kur siç e përmenda, ajo nuk konstaton apo nuk u jep vetë përgjigje pretendimeve të kërkesës që lidhen me procesin në gjykatat e faktit, bien ndesh me qëllimin e ligjit për karakterin seleksionues të dhomës së këshillimit. Për këtë arsye, vlerësimet që bën kolegji në dhomën e këshillimit, nuk mund të përbëjnë *a priori* proces të parregullt ligjor dhe të passjellin kurdoherë shfuqizimin e vendimeve nga Gjykata Kushtetuese. Një qëndrim i tillë është në kundërshtim me përmbajtjen e dispozitave kushtetuese dhe do ta kthente padrejtësisht Gjykatën Kushtetuese në një instancë më të lartë gjykimi (*shih vendimin nr. 210, datë 27.12.2001 të Gjykatës Kushtetuese*).

6. Për sa më sipër, vlerësoj se edhe në rastin konkret Gjykata e Lartë ka vepruar në përputhje me kompetencat e saj ligjore, si edhe në respektim të fuqisë detyruese të vendimit të Gjykatës Kushtetuese. Për pasojë, në kushtet kur pretendimet e paraqitura nga kërkuësja janë të pabazuara, Gjykata duhej të vendoste rrëzimin e kërkesës.

Anëtare: Altina Xhoxhaj

VENDIM Nr. 45, datë 29.6.2015

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“
Sokol Berberi	anëtar i	“	“
Vitore Tusha	anëtare e	“	“
Altina Xhoxhaj	anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“
Gani Dizdari	anëtar i	“	“
Fatos Lulo	anëtar i	“	“
Besnik Imeraj	anëtar i	“	“



me sekretare Blerina (Çinari) Basha, në datën 3.2.2015 Gjykata Kushtetuese mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 67/34 Akti, që i përket:

KËRKUES: Betim Truci

SUBJEKT I INTERESUAR: Komuniteti Mysliman i Shqipërisë

OBJEKTI: Shfuqizimi si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i vendimeve nr. 00-2013-1026, datë 10.5.2013 të Gjykatës së Lartë dhe nr. 1446, datë 20.6.2011 të Gjykatës së Apelit Tiranë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131/f, 134/g dhe 142/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Besnik Imeraj; kërkuasin që në parashtrimet e tij me shkrim ka kërkuar pranimin e kërkesës; subjektin e interesuar që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kërkuesi Betim Truci ka qenë anëtar i Kryesisë së Këshillit të Përgjithshëm të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë (KMSH-së). Me vendimet nr. 12 dhe nr. 13 të datës 15.9.2010 të këtij këshilli, është bërë shkarkimi i kërkuarit dhe tre anëtarëve të tjerë të KMSH-së.

2. Kërkuesi ka pretenduar se të dyja mbledhjet janë zhvilluar pa pasur kuorumin e duhur të parashikuar në statut dhe rregullore, si rrjedhojë vendimet që janë marrë në këto mbledhje kanë qenë të pavlefshme. Për këto arsye, kërkuasi ka paraqitur padi në Gjykatën e Tiranës me objekt: “Shfuqizimin e vendimit të Këshillit të Përgjithshëm të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, datë 18.9.2010 dhe të vendimeve nr. 12 dhe nr. 13, datë 15.9.2010 të Kryesisë së Komunitetit Mysliman të Shqipërisë”.

3. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 480, datë 31.1.2011, ka pranuar padinë, duke konstatuar pavlefshmërinë absolute të vendimeve nr. 12 dhe 13 të datës 15.9.2010 të Kryesisë së Komunitetit Mysliman të Shqipërisë.

4. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 1446, datë 20.6.2011 ka prishur vendimin e Gjykatës së Rrethit Tiranë, duke pushuar

gjykimin e kësaj çështjeje. (Gjykata e Apelit Tiranë ka arsyetuar se padia e ngritur mbeti pa objekt dhe se ajo duhet të konsiderohet si një padi që nuk mund të ngrihet). Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 00-2013-1026, datë 10.5.2013, ka vendosur mospranimin e rekursit.

II

5. **Kërkuesi** Betim Truci pretendon shqyrtimin e kërkesës së tij të paraqitur në Gjykatën Kushtetuese, duke parashtruar këto shkaqe:

5.1 Nxjerrja jashtë juridiksionit gjyqësor ka shkelur të drejtat kushtetuese.

5.2 Komuniteti Mysliman ka pranuar regjimin juridik të vendosur nga shteti shqiptar, duke u regjistruar sipas rregullave të përgjithshme, dhe nuk ka se si të shmanget nga këto rregulla.

5.3 Komuniteti Mysliman i Shqipërisë (KMSH-ja) është një shoqatë jofitimprurëse, por është e qartë, gjithashtu, se ka statutin e personit juridik dhe është i detyruar të zbatojë legjislacionin në fuqi.

6. **Subjekti i interesuar**, Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, parashtron si më poshtë:

6.1 Neni 10 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë garanton pavarësinë e bashkësive fetare nga shteti.

6.2 KMSH-ja nuk është organizatë jofitimprurëse, dhe gëzon një status të veçantë.

6.3 KMSH-ja është një bashkësi fetare që gëzon personalitet juridik.

6.4 Shteti shqiptar ka ratifikuar ligjin nr. 10056, datë 22.1.2009, “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komunitetit Mysliman të Shqipërisë për rregullimin e marrëdhënieve të ndërsjella”.

6.5 Vendimet e KMSH-së nuk mund të ankimohen në gjykatë për shkak të karakterit “*sui generis*” të bashkësive fetare.

6.6 Bashkësitë fetare gëzojnë tradicionalisht një autonomi organizative të garantuar në kuadër të nenit 9 të KEDNJ-së.

III

Vlerësimi i gjykatës

7. Gjykata Kushtetuese (Gjykata) vlerëson se pretendimet e ngritura nga kërkuasi janë haptazi të pabazuara.



8. Në referim të kriterëve ligjore për legjitimimin, Gjykata vëren se kërkuesi legjitimohet *ratione personae* dhe *ratione temporis*, pasi kërkesa ka të bëjë me ankimin individual për shkeljen e së drejtës për një proces të rregullt ligjor dhe është paraqitur brenda afatit 2-vjeçar të kërkuar nga ligji.

A. Lidhur me cenimin e së drejtës për t'iu drejtuar gjykatës (e drejta e aksesit në gjykatë)

9. Gjykata konstaton se kërkuesi, duke pretenduar se Gjykata e Apelit Tiranë ka nxjerrë pa të drejtë çështjen jashtë juridiksionit gjyqësor, sipas standardeve kushtetuese, ky pretendim lidhet me mohimin e aksesit për t'iu drejtuar Gjykatës.

10. Subjekti i interesuar ka parashtruar se neni 10 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë garanton pavarësinë e bashkësive fetare nga shteti dhe se vendimet e KMSH-së nuk mund të ankimohen në gjykatë për shkak të karakterit “*sui generis*” të bashkësive fetare.

11. Gjykata vë në dukje, se Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, në nenin 42 të saj, ka garantuar të drejtën e individëve për një proces të rregullt ligjor për mbrojtjen e të drejtave, lirive e interesave të tyre kushtetuese dhe ligjore, ku një aspekt i rëndësishëm i së cilës është edhe e drejta për t'iu drejtuar gjykatës (e drejta e aksesit). E drejta e aksesit nënkupton jo vetëm të drejtën e individit për t'iu drejtuar gjykatës, por edhe detyrimin e shtetit që t'ia garantojë atij këtë mundësi (*shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr. 15, datë 17.4.2003; nr. 9, datë 2.4.2003; nr. 17, datë 18.7.2008; nr. 5, datë 6.3.2009*). Në rast se mohohet një e drejtë e tillë, procesi konsiderohet jo i rregullt, sepse aksesit në gjykatë është, para së gjithash, një kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera. Shteti i së drejtës nuk mund të konceptohet pa u njohur individëve të drejtën dhe mundësinë për t'iu drejtuar gjykatës.

12. Gjykata për rastin në shqyrtim e gjen të arsyeshme të analizojë shkurtimisht tablonë ligjore dhe marrëdhënien juridike të shtetit shqiptar me Komunitetin Fetar Mysliman, i cili ushtron aktivitetin e tij në Shqipëri.

13. E mbrojtur nga neni 9, liria e mendimit, ndërgjegjes dhe fesë përfaqëson një prej themeleve të një “shoqërie demokratike” sipas kuptimit të Konventës Evropiane për të Drejtat e

Njeriut (KEDNJ-së). Neni 10 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë garanton pavarësinë e bashkësive fetare nga shteti.

14. Gjykata konstaton se shteti shqiptar në plotësimin e kuadrit ligjor mbi marrëdhëniet e shtetit me fenë, ruajtjen dhe zhvillimin e harmonisë ndërfetare në vend, përveç marrëveshjeve me komunitete të tjera, me Komunitetin Mysliman në Shqipëri ka ratifikuar ligjin nr. 10056, datë 22.1.2009 “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komunitetit Mysliman të Shqipërisë për rregullimin e marrëdhënieve të ndërsjella”. Në nenin 11 të kësaj marrëveshjeje, i cili rregullon organizimin e Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, citohet se “*në marrëdhëniet me organet, institucionet dhe organizatat e tjera laike e fetare, brenda dhe jashtë vendit, besimtarët e Komunitetit Mysliman të Shqipërisë përfaqësohen nga organet, funksionarët dhe drejtuesit e formuar, të emëruar a zgjedhur në përputhje me statutin. Komuniteti Mysliman i Shqipërisë ka të drejtë të formojë organet e tij, të emërojë funksionarët dhe drejtuesit e tyre në mënyrë të pavarur, si dhe në përputhje me dispozitat e parashikuara në statutin e tij*”.

15. Në rastin në shqyrtim, kërkuesi Betim Truci ka qenë anëtar i Kryesisë së Këshillit të Përgjithshëm të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë. Me vendimet nr. 12 dhe nr. 13 të datës 15.9.2010 të këtij këshilli është bërë shkarkimi i kërkuesit dhe tre anëtarëve të tjerë të KMSH-së.

16. Kërkuesi ka pretenduar se të dyja mbledhjet janë zhvilluar pa pasur kuorumin e duhur të parashikuar në statut dhe rregullore, si rrjedhojë vendimet që janë marrë në këto mbledhje kanë qenë të pavlefshme. Për këto arsye, kërkuesi ka paraqitur padi në Gjykatën e Tiranës me objekt: “*Shfuqizimin e vendimit të Këshillit të Përgjithshëm të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, datë 18.9.2010 dhe vendimeve nr. 12 dhe nr. 13, datë 15.9.2010 të Kryesisë së Komunitetit Mysliman të Shqipërisë*”. Gjykata e Apelit Tiranë e ka nxjerrë çështjen jashtë juridiksionit gjyqësor. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Lartë

17. Gjykata vlerëson se sipas nenit 11/4 të ligjit nr. 10056, datë 22.1.2009 “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, për rregullimin e



marrëdhënieve të ndërsjella”, “Funksionarëve, drejtuesve dhe organeve të bashkësisë u garantohej liri e plotë e ushtrimit të veprimtarisë fetare, organizative e administrative, në përputhje me aktet e këtij Komuniteti, për aq sa kjo veprimtari nuk vjen në kundërshtim me dispozitat kushtetuese dhe ligjore.

18. Edhe në jurisprudencën e konsoliduar të GJEDNJ-së, kjo gjykatë ka konstatuar se ka pasur shkelle të nenit 9 të KEDNJ-së. Në çështjen *Hasan dhe Chaush vs Bullgaria* kërkuessit, një ish-kryetar Myfti i fesë myslimane bullgare dhe një mësues i fesë islame, ankimuan për vendimin e autoriteteve bullgare për ndërrimin e drejtimit dhe të statutit të komunitetit mysliman. Këshilli i Ministrave refuzoi të regjistrojë udhëheqjen, pavarësisht nga fakti që Gjykata e Lartë Administrative e kishte dhënë dy herë të drejtë zotit Hasan kundër refuzimit të Këshillit të Ministrave për të regjistruar aktet nënligjore dhe leadershipin. Gjykata konstatoi se kishte pasur ndërhyrje në organizimin e brendshëm të komunitetit mysliman dhe lirisë së fesë”.

19. Në vendimin e saj GJEDNJ-ja konsideroi se faktet tregojnë se dështimi i autoriteteve që të mbeten neutrale në ushtrimin e kompetencave të tyre në lidhje me regjistrimin administrativ të komuniteteve fetare, çon në përfundimin se shteti kishte ndërhyrë në lirinë e besimtarëve për të manifestuar fenë e tyre brenda kuptimit të nenit 9. Kjo ndërhyrje, sipas GJEDNJ-së duhet të bazohet në një ligj që ofron mbrojtje të mjaftueshme kundër kufizimit arbitrar të të drejtave themelore. Në rastin në fjalë, GJEDNJ-ja u shpreh se legjislacioni bullgar nuk ka kriteret të qarta dhe të parashikueshme për regjistrimin e udhëheqjes së një komuniteti fetar dhe për këtë arsye nuk ishte në përputhje me standardet e Konventës Evropiane. Në përfundim, GJEDNJ-ja theksoi se ndërhyrja në jetën organizative të fesë myslimane dhe si pasojë në lirinë e ankuessve për të manifestuar besimin e tyre nuk ishte “e parashikuar me ligj”, arbitrarë si dhe e bazuar në dispozita ligjore që nuk kishin plotësuar standardet e kërkuara për qartësi dhe parashikueshmëri (*shih vendimin e GJEDNJ-së, Aplikimi nr. 30985/96, datë 26.10.2000*).

20. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë, e cila e ka nxjerrë çështjen jashtë juridiksionit, pa e zgjidhur atë në themel, dhe vendimi i mospranimi i Gjykatës së Lartë nuk i kanë cenuar kërkuessit të drejtën e aksesit në gjykatë, si aspekt i së drejtës për një

proces të rregullt ligjor, parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës.

21. Në këtë kontekst, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkuessit nuk i nënshtrohen kontrollit kushtetues, për rrjedhojë janë haptazi të pabazuara.

B. Lidhur me pretendimet e tjera

22. Kërkuessi në thelb të disa pretendimeve, vë theksin se Gjykata e Apelit Tiranë dhe Gjykata e Lartë kanë keqinterpretuar dhe keqzbatuar ligjin.

23. Gjykata ka theksuar se procesi i gjykimit kushtetues është i natyrës argumentuese, që nënkupton se u takon palëve të parashtrajnë argumentet faktike dhe ligjore mbi të cilat mbështesin pretendimet e tyre. Është detyrë e palëve të shpjegojnë arsyet të cilat kanë çuar, sipas këndvështrimit të tyre, në shkeljen e Kushtetutës dhe, më konkretisht, të procesit të rregullt ligjor. Në këtë kuptim, Gjykata vlerëson se kërkuessi nuk ka arritur të parashtrajë në mënyrë të plotë faktet dhe pretendimet, mbi bazën e të cilave mbështet pretendimin për cenim të nenit 42 të Kushtetutës. Ai nuk ka arritur të sjellë argumente të mjaftueshme për të argumentuar se në ç’mënyrë është cenuar në të drejtën e tij kushtetuese për një proces të rregullt ligjor nga procesi gjyqësor i zhvilluar në gjykatat e zakonshme.

24. Gjykata Kushtetuese vlerëson se pretendimet e paraqitura janë haptazi të pabazuara, për rrjedhojë kërkesa duhet rrëzuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, shkronja “a” dhe 134/1, shkronja “P”, të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Sokol Berberi, Fatmir Hoxha, Altina Xhoxhaj, Vitore Tusha, Besnik Imeraj, Fatos Lulo, Gani Dizdari

Anëtarë kundër: Bashkim Dedja (kryetar), Vladimir Kristo



MENDIM PAKICE

Jam kundër vendimit të shumicës për arsyet e mëposhtme:

1. Kërkuesi Betim Truci i është drejtuar Gjykatës për shfuqizimin si të papajtueshme me Kushtetutën të vendimeve nr. 1446, datë 20.6.2011 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe nr. 00-2013-1026, datë 10.5.2013 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

2. Në thelb kërkuesi ka pretenduar se vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë, duke konsideruar se kërkesëpadia e tij, me objekt shfuqizimin e vendimeve të Këshillit të Përgjithshëm dhe të Kryesisë së Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, nuk mund të ngrihej, si dhe duke vendosur pushimin e gjykimit të çështjes, i ka cenuar atij të drejtën e aksesit në gjykatë. Edhe vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi) për mospranimin e rekursit të tij nuk i ka dhënë përgjigje këtij pretendimi.

3. Në jurisprudencën e Gjykatës e drejta e aksesit u garanton subjekteve të cenuara të drejtën t'i drejtohen një gjykate, e cila do t'i dëgjojë pretendimet e tyre dhe do të shpallë një vendim pas një gjykimi të drejtë dhe publik. Gjykata ka vlerësuar vazhdimisht se administrimi i mirë i drejtësisë fillon me garancinë që një individ të ketë akses në gjykatë për t'i siguruar atij të gjitha aspektet e një forme gjyqësore të shqyrtimit të çështjes. Në këtë kuptim, ky standard përfshin të drejtën për gjykim, ku e drejta e aksesit, që është e drejta për të vënë në lëvizje gjykatën, për çështjet civile përbën një aspekt të saj. E drejta e aksesit në një organ gjyqësor duhet të jetë një e drejtë që lidhet me themelin dhe jo një e drejtë e pastër formale. Aksesit në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal. Mohimi i së drejtës për t'iu drejtuar gjykatës dhe për të marrë një përgjigje përfundimtare prej saj për pretendimet e ngritura, përbën cenim të së drejtës themelore për një proces të rregullt ligjor (*shih vendimet nr. 7, datë 27.2.2013, nr. 14, datë 26.3.2012; nr. 4, datë 23.2.2011; nr. 14, datë 3.6.2009; nr. 7, datë 11.3.2008 të Gjykatës Kushtetuese*).

4. Gjithashtu, Gjykata ka vlerësuar se neni 42 i Kushtetutës sanksionon në vetvete jo vetëm të drejtën e individit për t'iu drejtuar gjykatës, por edhe detyrimin e shtetit që t'ia garantojë atij këtë

akses. Gjykata ka konsideruar se sipas këtij neni detyrimi për të garantuar të drejtën efektive të aksesit në gjykatë nuk nënkupton thjesht mungesën e një ndërhyrjeje, por mund të kërkojë ndërmarrjen e veprimeve pozitive nga ana e shtetit. Në rast se mohohet një e drejtë e tillë, procesi konsiderohet jo i rregullt, sepse aksesit në gjykatë është para së gjithash një kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera. Shteti i së drejtës nuk mund të konceptohet pa u njohur individëve të drejtën dhe mundësinë për t'iu drejtuar gjykatës (*shih vendimet nr. 5, datë 6.3.2009; nr. 17, datë 18.7.2008; nr. 15, datë 17.4.2003 të Gjykatës Kushtetuese*).

5. Në rastin në shqyrtim, dy gjykata të niveleve të ndryshme, ajo e shkallës së parë dhe ajo e apelit, jo vetëm i kanë dhënë përgjigje diametralisht të kundërta zgjidhjes së konfliktit, por çka është edhe më e rëndësishme, gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se mund të shqyrtojë themelin e çështjes duke dhënë zgjidhjen përkatëse, ndërsa gjykata e apelit ka vendosur pushimin gjykimit, pasi sipas saj aktet e komuniteteve fetare, për shkak të marrëveshjeve të lidhura midis shtetit dhe këtyre komuniteteve fetare, nuk rregullohen nga ligji për organizatat jofitimprurëse dhe si të tilla nuk mund të konstatohen absolutisht të pavlefshme nga gjykata.

6. Në këto kushte, kërkuesi ka pretenduar se vendimi i gjykatës së apelit duke nxjerrë çështjen jashtë juridiksionit i ka mohuar atij të drejtën e aksesit në gjykatë, si në drejtim të së drejtës për t'iu drejtuar gjykatës ashtu edhe për të marrë përgjigje përfundimtare për pretendimet e ngritura. Për këtë qëllim ai i është drejtuar Gjykatës së Lartë. Këtyre pretendimeve Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë i përgjigjet me një vendim standard formal mospranimi të rekursit, i cili nuk përmban asnjë arsyetim jo vetëm për të kuptuar shkaqet e këtij qëndrimi, por edhe për ta përligjur vendimmarrjen e tij.

7. Gjykata është shprehur tashmë se kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor është funksion edhe i gjykatave të zakonshme, e aq më tepër i Gjykatës së Lartë. Kur në rekurs janë ngritur pretendime të cilat janë të rëndësishme për verifikimin e kushtetutshmërisë së procesit të zhvilluar në gjykatat e zakonshme, Gjykata e Lartë, bazuar në natyrën e gjykimit kushtetues të kërkesave



individuale, si dhe në parimin e subsidiaritetit, që udhëheq raportet ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme, duhet të investohet në ekzaminimin e tyre dhe të mbajë një qëndrim të shprehur lidhur me to (*shih vendimet nr. 4, datë 28.2.2006; nr. 41, datë 29.12.2005 të Gjykatës Kushtetuese*).

8. Në mendimin tim, e drejta për një proces të rregullt ligjor nuk mund të respektohet pa siguruar garancitë konkrete për individin për të drejtën për të vënë në lëvizje gjykatën, pra të drejtën për të filluar një proces që të vendosë për mosmarrëveshjet me natyrë civile. Çështja objekt shqyrtimi paraqet pikërisht veçori të kësaj natyre, pasi gjykata e apelit duke vendosur pushimin e gjykimit, i ka cenuar kërkuesit të drejtën e aksesit në gjykatë, si një prej të drejtave themelore të individit në një proces të rregullt ligjor dhe, në këtë drejtim, Gjykata e Lartë duke mos arsyetuar vendimin e saj nuk i ka dhënë përgjigje këtij pretendimi të tij.

9. Duke shkuar më tej, rasti konkret paraqet si karakteristikë edhe ekzistencën e dy vendimeve të kundërta të gjykatave të faktit në zgjidhjen e konfliktit konkret. Personalisht jam shprehur mbi këtë rrethanë (*shih mendimet paralele të vendimeve nr. 3, datë 19.2.2013; nr. 26, datë 24.6.2013; nr. 37, datë 30.6.2014 të Gjykatës Kushtetutës*), por edhe Gjykata ka mbajtur qëndrim duke theksuar se roli i Gjykatës së Lartë, si gjykatë e ligjit, është i një natyre të pazëvendësueshme. Ajo i ka të gjitha mjetet dhe kompetencat për të pasur një rol aktiv që shkon përtej ligjit dhe synon të drejtën, duke ndikuar efektivisht edhe në vendimarrjen e gjykatave të shkallëve më të ulëta, veçanërisht në rastet kur dy gjykata u kanë dhënë përgjigje diametralisht të kundërta pretendimeve të kërkuesit. Nga kjo pikëpamje, Gjykata ka vlerësuar se në çështje të tilla (që shqyrtohen rast pas rasti) kërkuesit, duke mos marrë përgjigje për pretendimet e tij me natyrë kushtetuese, për shkak të vendimit të mospranimit të rekursit, i cenohet e drejta e ankimit në kuptimin substancial, e parashikuar në nenin 43 të Kushtetutës (*shih vendimin nr. 3, datë 5.2.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

10. Si përfundim, në këto kushte, vlerësoj se Gjykata e Lartë duhej ta kalonte çështjen për shqyrtim në seancë plenare dhe të shprehej me vendim të arsyetuar për pretendimet e ngritura nga kërkuesi.

Anëtar: Vladimir Kristo

VENDIM Nr. 46, datë 29.6.2015

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“
Sokol Berberi	anëtar i	“	“
Vitore Tusha	anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“
Gani Dizdari	anëtar i	“	“
Besnik Imeraj	anëtar i	“	“
Fatos Lulo	anëtar i	“	“
Altina Xhoxhaj	anëtare e	“	“

me sekretare Blerina Basha, në datën 3.12.2014 mori në shqyrtim në seancë plenare, me dyer të hapura, çështjen me nr. 53/21 Akti, që u përket:

KËRKUES: Jo më pak se një e pesta e deputetëve të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar në gjykim nga Ivi Kaso dhe Gazmend Bardhi, me autorizim.

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar në gjykim nga Alban Brati, me autorizim.

Këshilli i Ministrave, përfaqësuar në gjykim nga Sokol Pasho, me autorizim.

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, i nenit 2 të ligjit nr. 100/2014, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative””.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 7, 42, 124, 131/a, 134/c, 144 dhe 145 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Altina Xhoxhaj, përfaqësuesit e kërkuesit, të cilët kërkuan pranimin e kërkesës, përfaqësuesit e subjekteve të interesuara, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë dhe Këshilli i Ministrave, të cilët kërkuan rrëzimin e kërkesës, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,



VËREN:

I

1. Kuvendi i Republikës së Shqipërisë (*Kuvendi*) ka miratuar ligjin nr. 49/2012, datë 3.5.2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” (*ligji nr. 49/2012*). Mes të tjerash ligji parashikon se në veprimtarinë e tij gjyqtari i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit Administrativ ndihmohet nga ndihmësi ligjor, si edhe detyrat që kryen ky i fundit (neni 6).

2. Me ligjin nr. 100/2014, datë 31.7.2014, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”” (*ligji nr. 100/2014*), Kuvendi ka miratuar disa ndryshime në ligjin nr. 49/2012. Më konkretisht, me nenin 1 të ligjit nr. 100/2014 janë bërë disa ndryshime në nenin 6, të ligjit nr. 49/2012, kurse me nenin 2 të ligjit nr. 100/2014, pas nenit 6 të ligjit nr. 49/2012 janë shtuar disa nene të tjera, të cilat parashikojnë procedurat për emërimin, lirimimin dhe shkarkimin nga detyra të ndihmësit ligjor (neni 6/1), nivelin e pagës së ndihmësit ligjor (neni 6/2), kushtet që duhet të plotësojë kandidati për këtë pozicion (neni 6/3), procedurën për shpalljen e vendit vakant (neni 6/4), si dhe formulën e përbërjes së komisionit *ad hoc* të ngarkuar me zhvillimin e testimit seleksionues dhe nxjerrjen e rezultateve të tij (neni 6/5).

II

3. **Kërkuesi, jo më pak se një e pesta e deputetëve të Kuvendit**, i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) me kërkesë për shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën, të nenit 2, të ligjit nr. 100/2014 dhe parashtron këto shkaqe:

3.1 Pavarësia e gjyqësorit është një nga shtyllat qendrore të shtetit të së drejtës, për shkak të pozicionit që zë dhe rolit që luan gjyqësori në një shoqëri demokratike. Në bazë të formulimit të nenit 7 të Kushtetutës pushtetet janë të ndara dhe midis tyre duhet të ketë një balancë. Në nenin 145 të Kushtetutës deklarohet se gjyqtarët janë të pavarur dhe u nënshtrohen vetëm Kushtetutës dhe ligjeve dhe ky nen ndalon

ndërhyrjen në veprimtarinë e gjykatave dhe të gjyqtarëve.

3.2 Një nga mjetet më të rëndësishme për mbrojtjen e organeve apo të institucioneve të pushtetit gjyqësor është veçanërisht përcaktimi i saktë i mekanizmave dhe procedurave për zgjedhjen, emërimin dhe sidomos shkarkimin jo vetëm të gjyqtarëve, por edhe të personelit administrativo-teknik të shërbimeve të gjykatës.

3.3 Duke pasur parasysh frymën dhe përmbajtjen e neneve 7, 42, 144 dhe 145 të Kushtetutës, roli i ndihmësit ligjor nuk mund të ndahet nga funksioni i dhënies së drejtësisë dhe përbën një element të rëndësishëm të pavarësisë organizative të pushtetit gjyqësor. Ndihmësi ligjor ndihmon dhe këshillon gjyqtarin lidhur me përgatitjen e çështjeve për gjykim, pra roli i tij është i një rëndësie thelbësore për gjykatën dhe gjyqtarin në dhënien e drejtësisë.

3.4 Kushtetuta nuk e lejon ndikimin e ministrit të Drejtësisë në procesin e emërimit apo të shkarkimit të ndihmësit ligjor dhe as nuk i njeh këtij të fundit një rol parësor në organizimin dhe drejtimin e procesit të emërimit apo të shkarkimit. Nga ndryshimi i miratuar me nenin 2 të ligjit nr. 100/2014 rezulton se kancelarit (i cili është vartës i ministrit të Drejtësisë) i është njohur e drejta ekskluzive për propozimin e emërimit, të lirimimit dhe të shkarkimit të ndihmësit ligjor, ndërkohë që përzgjedhja e kandidatëve bëhet sipas një procesi të përcaktuar me urdhër të ministrit nga një komision *ad hoc*.

3.5 Në kuadër të pavarësisë organizative dhe funksionale të pushtetit gjyqësor, duhet që vetë gjykata të ketë një rol parësor dhe jo dytësor në procedurën e emërimit, të lirimimit dhe të shkarkimit të ndihmësit ligjor. Është e papranueshme që me ligj t’i njohësh rol parësor në këtë proces ministrit të Drejtësisë jo vetëm për të realizuar procesin e konkurrit, por edhe për shpalljen e fituesve dhe propozimin e emërimit.

3.6 Nga ana tjetër, përbërja e komisionit *ad hoc*, në shumicën e tij me persona nga jashtë sistemit gjyqësor, është premisë e qartë për ndërhyrje të papërshtatshme në pavarësinë e pushtetit gjyqësor. Ky komision, për sa kohë do të veprojë sipas rregullave të përcaktuara nga ministri i Drejtësisë, *de facto* do të vendoset nën varësinë e tij.



4. **Subjekti i interesuar Kuvendi** në seancë plenare ka propësuar para Gjykatës sa vijon:

4.1 Në aspektin e pavarësisë funksionale ndihmësi ligjor, edhe sipas përcaktimeve të ligjit, nuk është subjekt procedural dhe në këtë kuptim nuk ndikon në procesin gjyqësor.

4.2 Në aspektin e pavarësisë organizative, do të ishte e tepërt të ngarkohej trupa gjyqësore me një funksion tjetër veç dhënies së drejtësisë, që është ai i rekrutimit të ndihmësve ligjorë, i cili do të bëhet nëpërmjet një procesi hallka të të cilit janë si struktura të pushtetit gjyqësor, përfaqësuar nga kryetari i gjykatës dhe kancelari, ashtu edhe të Ministrisë së Drejtësisë. Në të gjithë këtë proces është ruajtur dhe respektuar parimi i ndarjes dhe balancimit ndërmjet pushteteve.

4.3 Kërkuesi ka bërë objekt të gjykimit të gjithë nenin 2 të ligjit nr. 100/2014, por ai rezulton të jetë përqendruar kryesisht te procedura e emërimit dhe jo tek aspektet e tjera, për të cilat nuk ka paraqitur argumente për jokushtetutshmërinë e tyre.

4.4 Kuvendi u qëndron të njëjtave propësime të Këshillit të Ministrave, për arsye se ligji objekt shqyrtimi është një nismë legislative e Këshillit të Ministrave dhe Kuvendi, gjatë veprimtarisë së shqyrtimit të kësaj iniciative, ka respektuar të gjitha procedurat parlamentare.

5. **Subjekti i interesuar Këshilli i Ministrave** në parashtrimet e tij përpara Gjykatës ka propësuar sa vijon:

5.1 Qëllimi i ndërhyrjes së ligjvënësit në miratimin e ligjit nr. 100/2014 ka qenë plotësimi i vakuumit në ligjin për administratën gjyqësore, i cili nuk përmbante asnjë parashikim për statusin e ndihmësit ligjor. Në tërësinë e tij ai është konceptuar në mënyrë të tillë që t'u garantojë gjykatave administrative kushtet e nevojshme për ushtrimin në pavarësi të plotë të funksionit të tyre.

5.2 Në këndvështrim të parimit të ndarjes dhe balancimit ndërmjet pushteteve është treguar gjithë kujdesi i mundshëm që në kontekstin e parashikimit të statusit të ndihmësit ligjor të respektohet në çdo aspekt, qoftë edhe formal, ky parim. Formulimi në dispozitat e kundërshtuara ka ndërthurur më së miri kompetencat e kancelarit dhe të kryetarit të gjykatës si hallka të një procesi gjithëpërfshirës, i cili kërkon

veprimtarinë e disa aktorëve njëherazi. Po ashtu formulimi nuk lë vend për ambiguitet, pasi përcakton një ndarje të qartë të kompetencave midis këtyre dy subjekteve dhe për më tepër kompetencën e emërimit ia atribuon kryetarit të gjykatës. Fakti që kancelari është emërtesë e ministrit të Drejtësisë, nuk krijon apriori mundësinë që të komprometohet procesi i emërimit të ndihmësit ligjor dhe, për më tepër, të sjellë implikime të natyrës kushtetuese, për sa kohë ligji i njeh atij vetëm të drejtën e propozimit.

5.3 Në rastin e procedurës së shkarkimit ligjvënësi ka shtuar edhe një element tjetër garancie, duke kërkuar mendimin me shkrim të gjyqtarit përkatës pranë së cilit ndihmësi ushtron detyrën.

5.4 Edhe në lidhje me komisionin *ad hoc*, në respektim të parimit të ndarjes dhe balancimit ndërmjet pushteteve, është pasur kujdes që formula apo përbërja të jetë e balancuar dhe e padominuar nga asnjë aktor apo përfaqësues. Përbërja e këtij komisioni është dukshëm neutrale dhe garanton paanshmërinë në vendimarrje.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuesit

6. Sipas nenit 131, shkronja “a”, të Kushtetutës, Gjykata ka juridiksion të shqyrtojë pajtueshmërinë e ligjit me Kushtetutën. Çështjen e legjitimitimit (*locus standi*) Gjykata e ka vlerësuar si një ndër aspektet kryesore që lidhen me iniciimin e një procesi kushtetues. Për sa i përket kërkuesit, bazuar në nenin 134, pika 1, shkronja “c”, të Kushtetutës, si dhe në nenin 49, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000, ai legjitimohet t'i drejtohet Gjykatës për pajtueshmërinë e ligjit me Kushtetutën sipas objektit të kërkesës. Kërkuesi përfaqëson një subjekt me legjitimitet të pakushtëzuar dhe si i tillë ka të drejtë të kërkojë kontrollin abstrakt të kushtetutshmërisë së ligjit objekt shqyrtimi.

7. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se kërkuesi, një grup prej 30 deputetësh të Kuvendit, legjitimohet për vënien në lëvizje të këtij gjykimi kushtetues.

B. Për pretendimin për cenimin e neneve 7 dhe 145 të Kushtetutës



8. Gjykata vëren se kërkuksi, edhe pse në objekt të kërkesës ka kundërshtuar të gjithë përmbajtjen e nenit 2 të ligjit nr. 100/2014, pretendimet e tij i referohen vetëm përmbajtjes së neneve 6/1, 6/4 dhe 6/5 të ligjit nr. 49/2012 (shtuar me nenin 2 të kundërshtuar), të cilat rregullojnë procedurën e konkurrimit e të emërimit të ndihmësve ligjorë, si edhe përbërjen e komisionit *ad hoc* përgjegjës për zhvillimin e konkursit. Për pasojë, kontrolli i Gjykatës do të ndalet vetëm mbi përmbajtjen e këtyre dispozitave, pa u ndalur në ato që i referohen pagës dhe kriterëve për përzgjedhjen e ndihmësit ligjor, konkretisht nenet 6/2 dhe 6/3, për të cilat kërkuksi nuk ka paraqitur asnjë argument të natyrës kushtetuese.

9. Sipas kërkuksit parashikimet e këtyre dispozitave nuk respektojnë nenet 7 dhe 145 të Kushtetutës. Për shkak të pozicionit të ndihmësit ligjor, është vetë gjykata që duhet të ketë një rol parësor në procedurën e emërimit, të lirit dhe të shkarkimit të tij. Po ashtu, kërkuksi pretendon se përbërja e komisionit *ad hoc* përbën premisa për ndërhyrje të papërshtatshme në pavarësinë e pushtetit gjyqësor.

10. Sipas subjekteve të interesuara, roli që ka kancelari në procesin e emërimit apo të shkarkimit të ndihmësit ligjor nuk sjell implikime të natyrës kushtetuese. Kurse në lidhje me komisionin *ad hoc* është pasur kujdes që përbërja të jetë e tillë që të garantojë paanshmërinë në vendimmarrje.

11. Gjykata ka theksuar se parimi i shtetit të së drejtës, i sanksionuar në nenin 4 të Kushtetutës, nënkupton veprimin e të gjitha institucioneve shtetërore sipas së drejtës në fuqi, si dhe supremacinë e Kushtetutës ndaj akteve të tjera normative. Si një nga elementet e shtetit të së drejtës, parimi i ndarjes dhe balancimit ndërmjet pushteteve, i sanksionuar në nenin 7 të Kushtetutës, nënkupton që ligjvënësi, ekzekutivi dhe gjyqësori janë të ndarë, efektivisht të pavarur dhe midis tyre duhet të ketë një balancë. Bazuar në këtë dispozitë asnjë nga pushtetet e tjera, ligjvënës dhe ekzekutiv, nuk mund të funksionojë si gjykatë dhe të ushtrojë detyrën e gjyqtarit (*shih vendimet nr. 11, datë 27.5.2004; nr. 20, datë 9.7.2009 të Gjykatës Kushtetuese*). Pushteti gjyqësor mund të përmbushë detyrimin dhe të ushtrojë funksionin e tij kushtetues për të

administruar drejtësi vetëm nëse është i lirë dhe i pavarur nga pushtetet e tjera. Roli i gjyqtarit dhe gjykatave në një shtet të tillë është, që ndërsa ushtrojnë funksionin e drejtësisë, ata duhet të sigurojnë zbatimin e normave të shprehura në Kushtetutë, të ligjeve dhe të akteve të tjera ligjore, të garantojnë shtetin e së drejtës dhe të mbrojnë të drejtat dhe liritë e njeriut. Në kuadrin e parimit të kontrollit dhe balancës ndërmjet pushteteve, varësia absolute e gjyqtarit ndaj ligjit është kushti dhe legjitimimi i kësaj pavarësie (*shih vendimin nr. 20, datë 9.7.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Parimi i pavarësisë së pushtetit gjyqësor e detyron pushtetin legjislativ të përcaktojë garanci të tilla pavarësie që sigurojnë paanshmërinë e gjykatave në vendimmarrjen e tyre dhe nuk lejojnë ndërhyrjen në këtë veprimtari. Kjo pavarësi mund të sigurohet me mjete të ndryshme, mes të tjerash, duke përcaktuar me ligj pavarësinë e tyre procedurale, organizative dhe vetëqeverisjen e gjykatave, statusin e gjyqtarëve dhe garancitë sociale (materiale) të gjyqtarit.

13. Gjykata ka theksuar se pavarësia e gjyqësorit kuptohet si *pavarësi substanciale*, që do të thotë “liri e gjykatave për të dhënë vendime, të cilat nuk bazohen në interesat e ndonjë dege tjetër të pushtetit”; *pavarësi strukturale*, që lidhet me parashikimin në Kushtetutë apo në ligj të ekzistencës së institucionit, të mënyrës së formimit të përbërjes së tij; *pavarësi organizative*, që përfshin strukturimin e brendshëm administrativ të gjykatave; *pavarësi financiare*, që nënkupton autonomi në hartimin e buxhetit nga vetë institucioni dhe miratimin nga legjislativi, si një zë i veçantë i buxhetit të shtetit, fonde të përshtatshme e të mjaftueshme për të realizuar qëllimin dhe detyrat e institucionit e administrimit të tyre në mënyrë të pavarur; si dhe *pavarësi personale*, që kërkon emërim në bazë të kriterëve objektive, imunitet, garanci ekonomike, garanci për karrierën, sistem të transferimit dhe një sistem disiplinor (*shih vendimin nr. 11, datë 6.4.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Gjykata rithekson se roli dhe funksionimi i administratës gjyqësore nuk mund të ndahet nga funksioni i dhënies së drejtësisë dhe përbën një element të rëndësishëm të pavarësisë organizative të pushtetit gjyqësor. E konsideruar nga ligjvënësi si pjesë integrale e organizimit dhe



funksionimit të pushtetit gjyqësor dhe e interpretuar në jurisprudencën kushtetuese si pjesë organizative dhe funksionale e këtij pushteti, administrata gjyqësore gëzon të njëjtën mbrojtje procedurale kushtetuese, në kuadër të procedurës së miratimit të ligjeve me shumicë të cilësuar, njëllor siç parashikohet për pushtetin gjyqësor (*shih vendimin nr. 10, datë 6.3.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Kushtetuta nuk e lejon vendosjen e administratës gjyqësore nën varësinë e ministrit të Drejtësisë dhe as nuk i njeh këtij të fundit një rol parësor në organizimin dhe drejtimin e këtij shërbimi (*shih vendimin nr. 10, datë 6.3.2014 të Gjykatës Kushtetuese*). Po ashtu, shmangia e kryetarëve të gjykatave nga çështjet që lidhen me organizimin, drejtimin dhe kontrollin e përgjegjshmërisë së administratës gjyqësore, si dhe me emërimin dhe shkarkimin e personelit, krijon rrezikun e një ndikimi të papërshtatshëm në funksionin ekskluziv të gjyqësorit, dhënien e drejtësisë, si dhe i vendos strukturat brenda gjykatave në kushte të papërshtatshme për krijimin e marrëdhënieve të besimit, të cilat janë të nevojshme për ushtrimin normal të funksionit (*shih vendimin nr. 20, datë 9.7.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Gjykata ka theksuar se krijimi i raporteve të balancuara, ndërmjet pushtetit ekzekutiv dhe atij gjyqësor, duhet të orientohet nga standardi kushtetues i bashkëpunimit. Parimi i ndarjes dhe balancimit të pushteteve dhe fryma e Kushtetutës pranojnë bashkëpunim dhe bashkëveprim ndërmjet gjyqësorit dhe ekzekutivit lidhur me çështjet e administratës gjyqësore, por kjo duhet të organizohet në mënyrë të tillë që pavarësia e gjyqtarëve dhe gjykatave të mos shkelet (*shih vendimin nr. 10, datë 6.3.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Për efekt të rëndësisë që paraqet parimi i ndarjes dhe i balancimit të pushteteve, garancitë që ofron ligjvënësi, në kuptim të këtij parimi, duhet të jenë integrale e të përshkallëzuara nga niveli menaxhues deri në atë ekzekutues. Në këtë drejtim, çdo rregullim i ri ligjor nuk është i mjaftueshëm nëse nuk garanton shmangien e ndikimeve që mund të ushtrojë pushteti ekzekutiv në çështje që lidhen me dhënien e drejtësisë nga gjykata (*shih vendimin nr. 10, datë 6.3.2014 të Gjykatës Kushtetuese*). Në frymën e

dispozitave të Kushtetutës për pavarësinë e gjyqësorit dhe ndarjen e pushteteve, pushteti ekzekutiv, nëpërmjet ministrit të Drejtësisë, duhet ta konsiderojë si detyrë të tij garantimin e kushteve të përshtatshme të punës për gjykatat dhe gjyqtarët, në funksion të dhënies së drejtësisë. Ndërsa “kontrolli” si i tillë nuk duhet të cenojë elementet e pavarësisë, të cilat në thelb prekin vetë funksionin e dhënies së drejtësisë (*shih vendimin nr. 20, datë 9.7.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Në zbatim të funksionit të saj, Gjykata rithekson se është brenda hapësirës vlerësuese të ligjvënësit mënyra e rregullimit të një çështjeje të caktuar, ndërsa detyrë e saj është të kontrollojë nëse rregullimi me ligj i kësaj çështjeje është bërë në përputhje me Kushtetutën dhe parimet themelore të saj (*shih vendimin nr. 30, datë 1.12.2005 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Gjykata vëren se sipas ligjit nr. 9877, datë 18.2.2008, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” (*ligji nr. 9877/2008*) shërbimet ndihmëse në gjykatë kryhen nga sekretaria gjyqësore, degët dhe sektorët e administratës, të ekonomisë, financës, informatizimit, regjistrimit dhe ruajtjes së dokumenteve (neni 39). Disa nga këto shërbime të administratës gjyqësore kryejnë edhe veprimtari të natyrës procedurale penale, civile ose administrative, të cilat janë pjesë e pandarë e një procesi të rregullt ligjor dhe luajnë një rol të rëndësishëm mbështetës për gjykatën dhe gjyqtarin në dhënien e drejtësisë.

20. Ligji nr. 49/2012 për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative, përveç përcaktimit të rregullave për organizimin, juridiksionin e kompetencën e gjykatave administrative, si dhe parimeve të procesit administrativ, ka parashikuar edhe një pozicion të ri ndihmës në veprimtarinë e gjyqtarit të shkallës së parë dhe atij të apelit, atë të ndihmësit ligjor, i cili në përputhje me nenin 6, pika 2, të këtij ligji, ndihmon dhe këshillon gjyqtarin lidhur me përgatitjen e çështjes për gjykim dhe shqyrtimin gjyqësor, si dhe përgatit projektakte procedurale të nevojshme për gjykimin. Po ashtu, me kërkesë të gjyqtarit, ndihmësi ligjor bën kërkime ligjore dhe përgatit opinione me shkrim për problematika ligjore të karakterit procedural dhe material që lidhen me çështjet në gjykim.



21. Duke pasur parasysh rregullimet ligjore aktuale për administratën gjyqësore, Gjykata vëren se në lidhje me këtë funksion janë parashikuar disa elemente të veçanta rregullimi që i referohen parashikimit të së drejtës së ministrit të Drejtësisë për caktimin e numrit të ndihmësve ligjorë për çdo gjykatë (neni 6), kategorizimin e nivelit të pagës në varësi të asaj të gjyqtarit (neni 6/2), parashikimin e një procedure të veçantë për përzgjedhjen e tyre (nenet 6/1 dhe 6/4), përcaktimin e kriterëve ligjorë për emërim, si dhe të shkaqeve për shkarkimin e tyre (neni 6/1, pika 4 dhe neni 6/3) etj. Megjithatë ligji nuk ka përcaktuar një status të ndryshëm të ndihmësit ligjor dhe funksioni kryesor i tij është kryerja e veprimtarisë administrative mbështetëse të gjyqtarit për realizimin me efektivitet të misionit të dhënies së drejtësisë, çka është edhe roli thelbësor i administratës gjyqësore në tërësinë e saj. Në këto kushte, pretendimet në lidhje me jokushtetutshmërinë e rregullimeve ligjore të kundërshtuara Gjykata do t'i vlerësojë në këndvështrim të respektimit të parimit të pavarësisë organizative të pushtetit gjyqësor dhe atij të ndarjes dhe balancimit ndërmjet pushteteve.

22. Gjykata vëren se sipas nenit 6/4 të ligjit nr. 49/2012, kryetari i gjykatës i komunikon strukturës përgjegjëse për administratën e gjyqësorit në Ministrinë e Drejtësisë vendet e lira për pozicionin e ndihmësit ligjor në gjykatë, të cilat duhet të shpallen për konkurs të hapur. Kjo strukturë shpall datën e konkurrimit të hapur në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë, kurse kërkesat paraqiten pranë një komisioni *ad hoc*, i cili është kompetent për shqyrtimin e tyre dhe verifikimin e përmbushjes së kriterëve ligjorë, për organizimin dhe zhvillimin e testimit seleksionues, si dhe për publikimin e rezultateve. Lista me renditjen e kandidatëve fitues, sipas numrit të pikëve të marra, i dërgohet nga komisioni gjykatës përkatëse. Nga kjo listë, në përputhje me nenin 6/1 të po këtij ligji, kancelari përzgjedh dhe propozon për emërim ndihmësin ligjor, i cili emërohet në detyrë me urdhër të kryetarit të gjykatës. E njëjta procedurë propozimi dhe emërimi është parashikuar edhe për një kategori të caktuar kandidatësh, të cilët përjashtohen nga konkurrimi. Ndihmësi ligjor emërohet, lirohet apo shkarkohet nga detyra me

urdhër të kryetarit të gjykatës, me propozimin e kancelarit të gjykatës. Në lidhje me lirimin dhe shkarkimin nga detyra të ndihmësit ligjor, pika 3 e nenit 6/1, parashikon se propozimi i kancelarit të gjykatës shoqërohet edhe me mendimin me shkrim të gjyqtarit pranë të cilit ai ushtron detyrën.

23. Sipas kërkesit e gjithë procedura për përzgjedhjen dhe emërimin e kandidatëve, përfshirë edhe të drejtën e ministrit të Drejtësisë për të përcaktuar kriteret dhe procedurat e organizimit të testimit dhe të organizimit dhe funksionimit të komisionit *ad hoc*, përbën ndërhyrje në veprimtarinë e gjykatës dhe vë në dyshim standardin e bashkëpunimit ndërmjet pushteteve.

24. Duke i vlerësuar pretendimet e kërkesit në këndvështrimin kushtetues, Gjykata vlerëson se parashikimi i së drejtës së ministrit të Drejtësisë për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave të organizimit të testimit dhe të rregullave për organizimin dhe funksionimin e komisionit *ad hoc* nuk bie ndesh me parimin e ndarjes dhe balancimit ndërmjet pushteteve. Në kuptim të pozicionit kushtetues të ministrit të Drejtësisë, si përfaqësues i pushtetit ekzekutiv në marrëdhëniet me pushtetin gjyqësor, ai mbështet, bashkëpunon dhe bashkërendon veprimtarinë me organet e pushtetit gjyqësor dhe me prokurorinë. Në kuadër të këtij funksioni ai ushtron kompetenca që kanë të bëjnë, mes të tjerash, me hartimin dhe ndjekjen e politikave, përgatitjen e akteve ligjore dhe nënligjore, si dhe ushtrimin e shërbimeve të nevojshme lidhur me sistemin gjyqësor, si edhe kujdeset për organizimin dhe funksionimin e këtyre shërbimeve, në përgjithësi, dhe veprimtarinë e administratës gjyqësore, në veçanti. Ministri i Drejtësisë nuk ka asnjë kompetencë në procesin e emërimit dhe të shkarkimit të ndihmësve ligjorë as në mënyrë të drejtpërdrejtë, as nëpërmjet kancelarit pasi kjo është kompetencë e kryetarit të gjykatës. Ndërsa ministri i Drejtësisë ka vetëm kompetenca të natyrës organizative, vlerësimi hap pas hapi i të gjitha kriterëve ligjorë, zhvillimi i testimit, vlerësimi i kandidatëve, deri në përcaktimin e fituesve sipas numrit të pikëve të marra, është një çështje që i përket ekskluzivisht komisionit të ngritur për këtë qëllim.

25. Për sa i përket së drejtës të kancelarit për



të përzgjedhur një kandidat nga lista e kandidatëve fitues dhe për t'ia propozuar atë kryetarit për emërim, Gjykata vlerëson se ky parashikim është në përputhje me përmbajtjen e nenit 37 të ligjit nr. 9877/2008, sipas të cilit kancelari i gjykatës drejton dhe përgjigjet për shërbimet ndihmëse në gjykatë. E drejta e kancelarit për të propozuar emërimin dhe shkarkimin e ndihmësit ligjor është në përputhje me funksionin e tij për drejtimin, organizimin dhe mbikëqyrjen e përditshme të veprimtarisë administrative, si nëpunësi më i lartë administrativ i institucionit.

26. Në kuptim të pavarësisë organizative të gjykatës, si pjesë e pavarësisë së pushtetit gjyqësor, parashikimet ligjore të kundërshtuara kanë respektuar detyrimin për përfshirjen e kryetarit të gjykatës në çështjet që lidhen me organizimin, drejtimin dhe kontrollin e përgjegjshmërisë së administratës gjyqësore dhe i kanë njohur atij instrumentet e duhura ligjore për këtë qëllim. Për pasojë, formula e përzgjedhur nga ligjvënësi nuk passjell asnjë ndikim të drejtpërdrejtë të ministrit në procesin e emërimit dhe të shkarkimit të administratës gjyqësore (ndihmësit ligjorë), por përcakton dhe respekton përgjegjësitë e drejtpërdrejta të kryetarit të gjykatës në këtë proces. Në kuptim të parimit të ndarjes dhe balancimit ndërmjet pushteteve parashikimi i një procedurë të tillë, ku për secilin nga organet që marrin pjesë në proces është parashikuar qartë hapësira e kompetencave të tyre, respekton detyrimin për bashkëpunim dhe bashkëveprim ndërmjet gjyqësorit dhe ekzekutivit lidhur me çështjet e administratës gjyqësore. Rregullimet ligjore objekt shqyrtimi kanë përcaktuar qartë mekanizmat dhe nivelin e bashkëpunimit për secilin nga aktorët që marrin pjesë në proces, duke i njohur veçanërisht kryetarit të gjykatës kompetenca të drejtpërdrejta për çështjet organizative dhe funksionale të administratës gjyqësore.

27. Për sa u përket pretendimeve që lidhen me komisionin *ad hoc*, Gjykata vëren se sipas nenit 6/5 të ligjit nr. 49/2012, ky komision ka në përbërje të tij kryetarin e gjykatës, ku janë shpallur vendet vakante, një gjyqtar të asaj gjykate, kancelarin e asaj gjykate, një përfaqësues të strukturës përgjegjëse për administratën gjyqësore në Ministrinë e Drejtësisë, një pedagog

të së drejtës administrative në institucionet e arsimit të lartë me gradë shkencore jo më të ulët se “Doktor”, si dhe dy pedagogë të Shkollës së Magjistraturës. Gjykata vlerëson se pavarësisht se ky organ ngrihet dhe funksionon jashtë pushtetit gjyqësor, mënyra e organizimit dhe formula e përbërjes së tij, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të nivelit drejtues të vetë gjykatës ku ka vende vakante, garanton përfshirjen e pushtetit gjyqësor në këtë proces, kurse përfshirja e anëtarëve nga institucionet akademike garanton cilësinë e përzgjedhjes në drejtëm të meritës së kandidatëve. Pavarësisht parashikimit për pjesëmarrjen në komision edhe të një përfaqësuesi të pushtetit ekzekutiv, kjo nuk ndikon në realizimin në mënyrë të pavarur të procedurës së konkursit apo të asaj për shpalljen e kandidatëve fitues. Për më tepër, Gjykata vlerëson se përbërja e komisionit është e balancuar dhe garanton jo vetëm paanshmërinë në vendimmarrje, por edhe që procesi i përzgjedhjes së ndihmësit ligjor t'i nënshtrohet një procedure konkurruese rekrutimi, transparente dhe merite, në përputhje me nenin 6, pika 4, të ligjit nr. 49/2012.

28. Në përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimet e paraqitura nga kërkuesi për cenimin e parimeve kushtetuese të ndarjes dhe balancimit ndërmjet pushteteve dhe të pavarësisë së pushtetit gjyqësor janë të pabazuara, për rrjedhojë kërkesa duhet të rrëzohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, shkronja “a” dhe 134, pika 1, shkronja “c”, të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash

VENDOSI:

Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar), Sokol Berberi, Vladimir Kristo, Fatmir Hoxha, Vitore Tusha, Fatos Lulo, Besnik Imeraj

Anëtarë kundër: Gani Dizdari, Altina Xhoxhaj



MENDIM PAKICE

1. Për arsye se nuk ndajmë të njëjtin qëndrim me shumicën për rrëzimin e kërkesës së paraqitur nga një e pesta e deputetëve të Kuvendit për kontrollin e kushtetutshmërisë së nenit 2 të ligjit nr. 100/2014, i cili ka sjellë disa ndryshime në ligjin nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, vlerësojmë të paraqesim argumentet për qëndrimin tonë në pakicë.

2. Bashkohemi me qëndrimin e shumicës se kërkuksi ka paraqitur argumente të natyrës kushtetuese vetëm për dispozitat e neneve 6/1, 6/4 dhe 6/5 të ligjit nr. 49/2012 (shtuar me nenin 2 të ligjit nr. 100/2014 të kundërshtuar), të cilat rregullojnë procedurën e konkurrimit e të emërimit të ndihmësve ligjorë, si edhe përbërjen e komisionit *ad hoc* përgjegjës për zhvillimin e konkursit.

3. Për sa u përket dispozitave të mësipërme, në thelb kërkuksi pretendon se e gjithë procedura për përzgjedhjen dhe emërimin e ndihmësve ligjorë nuk garanton pavarësinë e pushtetit gjyqësor, për shkak të ndikimit të ministrit të Drejtësisë dhe rolit dytësor që ka gjykata në këtë proces. Po ashtu, sipas kërkuksit për sa kohë që komisioni *ad hoc*, që kryen të gjithë procedurën e konkurrimit dhe shpall rezultatet, vepron sipas rregullave të përcaktuara nga ministri i Drejtësisë, ai vendoset nën varësinë e tij.

4. Gjykata ka marrë edhe më parë në shqyrtim çështje që lidhen me kontrollin e rregullimeve ligjore që prekin administratën gjyqësore, duke i trajtuar ato në kuadër të respektimit të parimit të ndarjes dhe balancimit ndërmjet pushteteve si element i parimit të shtetit të së drejtës. Bazuar në këto parime Gjykata ka vlerësuar si të papajtueshëm me Kushtetutën rregullimin ligjor të nenit 38/a të ligjit nr. 9877/2008, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i cili parashikonte të drejtën e kancelarit të gjykatës për të emëruar dhe shkarkuar personelin e sekretarisë gjyqësore dhe atë administrativo-teknik të shërbimeve të gjykatës. Në këtë vendim, Gjykata ka vlerësuar se “*roli dhe funksionimi i administratës gjyqësore nuk mund të ndahet nga funksioni i dhënies së drejtësisë dhe përbën një element të rëndësishëm të pavarësisë organizative të pushtetit gjyqësor. Në këtë kuptim, Kushtetuta nuk e lejon vendosjen e administratës gjyqësore*

nën varësinë e ministrit të Drejtësisë dhe as nuk i njeh këtij të fundit një rol parësor në organizimin dhe drejtimin e këtij shërbimi.... Skema e varësisë hierarkike ministër Drejtësie – kancelar – administratë gjyqësore, që parashikon ky ligj, sipas Gjykatës, mund të rezultojë në një situatë ku veprimtaria e gjykatës të varet nga veprimet e kancelarit, i cili emërohet dhe shkarkohet pa kritere të përcaktuara nga ministri i Drejtësisë. Gjykata çmon se duke pasur parasysh kuptimin e pavarësisë organizative të gjykatave, si shprehje e pavarësisë së gjyqësorit, shmangia e kryetarëve të gjykatave nga çështjet që lidhen me organizimin, drejtimin dhe kontrollin e përgjegjëshmërisë së administratës gjyqësore, si dhe me emërimin dhe shkarkimin e personelit, krijon rrezikun e një ndikimi të papërshtatshëm në funksionin ekskluziv të gjyqësorit, dhënien e drejtësisë, si dhe i vendos strukturat brenda gjykatave në kushte të papërshtatshme për krijimin e marrëdhënieve të besimit, të cilat janë të nevojshme për ushtrimin normal të funksionit...” (shih paragrafët 14-22 të vendimit nr. 20, datë 9.7.2009).

5. Në vitin 2013, Gjykata u vu në lëvizje për kontrollin e kushtetutshmërisë së ligjit nr. 109/2013, “Për administratën gjyqësore në Republikën e Shqipërisë”. Mes të tjerash, ky ligj parashikonte të drejtën e ministrit të Drejtësisë për të emëruar si nëpunës civilë gjyqësorë kandidatët e propozuar nga një komision *ad hoc* i ngritur për këtë qëllim. Në lidhje me këto parashikime ligjore, Gjykata ka vlerësuar se “*...rezulton se ligji kufizohet në afirmimin deklarativ të bashkëpunimit ndërmjet ministrit të Drejtësisë, kryetarit dhe kancelarit të gjykatës, pa përcaktuar mekanizmat dhe nivelin e këtij bashkëpunimi... Kështu, në kuptim të nenit 18 të ligjit, kryetari nuk gëzon kompetenca të qarta dhe të drejtpërdrejta për çështje organizative dhe funksionale të administratës gjyqësore; e kundërta vihet re në përcaktimin e kompetencave për ministrin e Drejtësisë dhe kancelarin... Referuar ligjit objekt shqyrtimi, Gjykata vëren se kompetencat dhe aktet nënligjore që ministri i Drejtësisë duhet të nxjerrë sipas ligjit objekt shqyrtimi, vënë në diskutim standardin e balancimit dhe bashkëpunimit ndërmjet pushtetit gjyqësor dhe administrativ, të përmendur më sipër. Kjo përforcohet edhe nga fakti se teknikisht ligjvënësi, në ushtrim të kompetencave për organizimin e administratës gjyqësore, i ka deleguar ministrit të Drejtësisë të drejtën për të nxjerrë urdhra, akte të cilat, në kuptim të nenit 119 të Kushtetutës, kanë karakter të brendshëm dhe të detyrueshëm për zbatim vetëm për njësitë administrative të varura nga ministri i Drejtësisë...” (shih paragrafët 31-34 të vendimit nr. 10, datë 6.3.2014).*



6. Duke krahasuar përmbajtjen e dispozitave të kundërshtuara me ato të ligjit nr. 109/2013 të shfuqizuar nga Gjykata, rezulton se ndërsa në këtë të fundit kompetenca për emërimin e nëpunësve gjyqësorë i njihej ministrit të Drejtësisë, në ligjin e ndryshuar nr. 49/2012 këtë kompetencë e ka kryetari i gjykatës, por tashmë me propozim të kancelarit, i cili duhet të përzgjedhë kandidatin nga lista e kandidatëve fitues të shpallur nga komisioni *ad hoc*. Por edhe pse në dukje krijohet përshtypja se është eliminuar ndikimi i drejtpërdrejtë i ministrit në procesin e emërimit dhe të shkarkimit të administratës gjyqësore, i gjithë procesi deri në emërim, pra shpallja e vendeve vakante, kriteret dhe procedurat e organizimit të testimit, si dhe organizimi dhe funksionimi i komisionit *ad hoc*, përcaktohen sërish me urdhër të ministrit të Drejtësisë. Ashtu si edhe në ligjin e shfuqizuar nr. 190/2013, edhe në ligjin e kundërshtuar komisioni *ad hoc* krijohet pothuajse me të njëjtën përbërje si më parë, por me ndryshimin se anëtarë të tij do të jenë edhe dy pedagogë të Shkollës së Magjistraturës. Pra, jemi para një komisioni që edhe pse në përbërje të tij ka kryetarin, një gjyqtar, si edhe kancelarin e gjykatës ku janë shpallur vendet vakante, ai krijohet dhe funksionon jashtë pushtetit gjyqësor. Është po ky komision që më pas i dërgon listën e kandidatëve të përzgjedhur gjykatës përkatëse, nga e cila kancelari i propozon kryetarit emrat e kandidatëve që do të emërohen.

7. Në lidhje me parashikimin e së drejtës së kancelarit për të propozuar për emërim njërin prej kandidatëve të përzgjedhur si fitues, nuk del i qartë qëllimi i ligjvënësit për këtë rregullim. Duke qenë se kancelari është vetë pjesë e komisionit *ad hoc* që përzgjedh kandidaturat fituese, të cilat më pas i dërgohen gjykatës përkatëse për përzgjedhjen e ndihmësit ligjor, duket si e tepërt futja e një hallke të tillë në procedurën e emërimit, edhe pse në dukje kancelari nuk ka një ndikim të drejtpërdrejtë në proces dhe propozimi i tij nuk është detyrues për kryetarin e gjykatës.

8. Po ashtu vlerësojmë se kompetenca e ministrit të Drejtësisë për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave të organizimit të testimit, si dhe për organizimin dhe funksionimin e komisionit *ad hoc* nuk është e pajtueshme me parimin e ndarjes dhe të balancimit të pushteteve, të sanksionuar në nenin 7 të Kushtetutës.

9. Parimi i pavarësisë së pushtetit gjyqësor, i

cili përfshin edhe pavarësinë organizative të tij, kërkon përjashtimin e çdo ndërhyrjeje në mënyrën se si ky pushtet vetëqeveriset dhe organizohet. Në çështje të tilla nuk mjafton të garantohet thjesht përfshirja e gjykatave (nëpërmjet kryetarit) në këtë proces, siç argumenton shumica, por duhet të garantohet një shkëputje totale e pushtetit ekzekutiv nga çështje që i përkasin pavarësisë organizative të pushtetit gjyqësor. Jo vetëm që arsyet për miratimin e këtyre parashikimeve ligjore nuk janë të qarta, por as vetë subjektet e interesuara nuk kanë arritur të argumentojnë se pse ka qenë e nevojshme një përfshirje e tillë e ministrit të Drejtësisë në procedurën e emërimit të ndihmësit ligjor, si pjesë e stafit administrativ të gjykatës.

10. Në vlerësimin tonë nuk ka asnjë pengesë që procesi i përzgjedhjes së ndihmësit ligjor nëpërmjet një procedure konkurruese rekrutimi, në respektim të standardeve të transparencës dhe meritokracisë së kandidatëve, të realizohet dhe arrihet brenda vetë sistemit gjyqësor, pa pasur nevojën e krijimit të strukturave të tilla nga ana e pushtetit ekzekutiv.

11. Në përfundim të sa më sipër, vlerësojmë se në rastin konkret kishte vend për pranimin e kërkesës dhe shfuqizimin e neneve 6/1, 6/4 dhe 6/5 të ligjit nr. 49/2012, shtuar me nenin 2 të ligjit nr. 100/2014 të kundërshtuar.

Anëtarë: Altina Xhoxhaj, Gani Dizdari

VENDIM

Nr. 80, datë 30.6.2015

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR SHQYRTIMIN DHE MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR PROCEDURAT E LICENCIMIT, MODIFIKIMIT, TRANSFERIMIT TË PJESSHËM OSE TË PLOTË, RINOVIMIT DHE HEQJES SË LICENCEVE”, NË SEKTORIN E ENERGISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 20, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, nenit 26 të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 21, datë 18.3.2009, i ndryshuar, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 30.6.2015, pasi shqyrtoi



draftin e përgatitur nga grupi i punës të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit, heqjes dhe rinovimit të licencave në sektorin e energjisë elektrike” dhe relacionin përkatës, për fillimin e procedurave për shqyrtimin dhe miratimin e rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të pjesshëm ose të plotë, heqjes dhe rinovimit të licencave”, në sektorin e energjisë elektrike,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për shqyrtimin dhe miratimin e rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të pjesshëm ose të plotë, heqjes dhe rinovimit të licencave”, në sektorin e energjisë elektrike.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrît Ahmeti

VENDIM

Nr. 81, datë 30.6.2015

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR
MIRATIMIN E RREGULLORES MBI
PROCEDURAT PËR CERTIFIKIMIN E
OPERATORIT TË SISTEMIT TË
TRANSMETIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 58 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”; nenit 26 të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 21, datë 18.3.2009, i ndryshuar, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 30.6.2015, pasi shqyrtoi draftin e përgatitur nga grupi i punës, të rregullores “Për certifikimin e operatorit të sistemit të transmetimit të energjisë elektrike”, dhe relacionin përkatës, për fillimin e procedurave për shqyrtimin dhe miratimin e rregullores “Për certifikimin e operatorit të sistemit të transmetimit të energjisë elektrike”,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për shqyrtimin dhe miratimin e rregullores “Për certifikimin e operatorit të sistemit të transmetimit të energjisë elektrike”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrît Ahmeti

VENDIM

Nr. 82, datë 30.6.2015

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR
SHQYRTIMIN DHE MIRATIMIN E
RREGULLORES PËR ORGANIZIMIN,
FUNKSIONIMIN DHE PROCEDURAT E
ERE-s**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe nenit 26 të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 21, datë 18.3.2009, i ndryshuar, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 30.6.2015, pasi shqyrtoi draftin e përgatitur nga grupi i punës, për “Rregulloren e organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, dhe relacionin përkatës, për fillimin e procedurave për hartimin e “Rregullores së organizimit funksionimit dhe procedurave të ERE-s”,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për shqyrtimin dhe miratimin e “Rregullores së organizimit funksionimit dhe procedurave të ERE-s”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrît Ahmeti

VENDIM

Nr. 83, datë 30.6.2015

**PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË
“GAMA ENERGY” SHPK, NË
AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC-et:
“LENA 1”, ME FUQI TË INSTALUAR 1.95
MW, “LENA 2” ME FUQI TË
INSTALUAR 2.3 MW DHE “LENA 2A”;
ME FUQI TË INSTALUAR 0.25 MW (ME
FUQI TOTALE 4.5 MW)**

Në mbështetje të neneve 2, germa “c”; 16; 37, pika 2, germa “a” dhe 39, pika 3, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”;



neneve 4, pika 1, germa “a”; 5, pika 1, germa “a”; dhe 13 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 30.6.2015, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Gama Energy” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe të Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe të Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie nga HEC-et: “Lena 1”, “Lena 2” dhe “Lena 2A”, konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Gama Energy” sh.p.k. plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni teknik lidhur me tipin e licencës (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4, 4.1.5) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Gama Energy” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et: “Lena 1”, me fuqi të instaluar 1.95 MW; “Lena 2”, me fuqi të instaluar 2.3 MW dhe “Lena 2A”, me fuqi të instaluar 0.25 MW (me fuqi totale 4.5 MW), për një afat 30-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, të Monitorimit të Tregut dhe të Licencuarve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM Nr. 84, datë 30.6.2015

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “LENGARICA & ENERGY” SHPK NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC “LENGARICA” ME FUQI TË INSTALUAR 8.94 MW

Në mbështetje të neneve 2, germa “c”; 16; 37, pika 2, germa “a” dhe 39, pika 3, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, neneve 4, pika 1, germa “a”; 5, pika 1, germa “a”; 10, pika 3, të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 108, datë 9.9.2008 dhe nenit 18, pika 1, germa “a” e “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 30.6.2015, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Lengarica & Energy” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe të Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe të Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie nga HEC “Lengarica”,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Lengarica & Energy” sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3), është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni teknik-ekonomik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4 dhe 4.1.5), është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për mungesën e dokumentacionit, që ka të bëjë me:

- Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) do të njoftohet subjekti që në bazë të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm



dhe rinovimit të licencave”, neni 10, pika 10 dhe neni 11, pika 1, t’i paraqesë këto në ERE, brenda afateve të përcaktuara.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë “Lengarica & Energy” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Lengarica”, me fuqi të instaluar 8.94 MW.

2. Drejtoria e Licencimit, e Monitorimit të Tregut dhe të të Licencuarve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI
Petrit Ahmeti**

VENDIM

Nr. 85, datë 30.6.2015

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR
LICENCIMIN E SHOQËRISË
“LENGARICA & ENERGY” SHPK, NË
AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 2, germa “c”; 16; 37, pika 2, germa “d” dhe 39, pika 3, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, neneve 4, pika 1, germa “g”; 5, pika 2; 10, pika 3 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 108, datë 9.9.2008, dhe nenit 18, pika 1, germa “a” e “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 30.6.2015, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Lengarica & Energy” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe të Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe të Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Lengarica & Energy” sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1) është plotësuar në mënyrë korrekte;

- Dokumentacioni juridik, administrator dhe pronësor (neni 9, pika 2, germa “a”, “b”, “c”, “d”, “e”) është plotësuar në mënyrë korrekte;

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është plotësuar në mënyrë korrekte;

- Të dhënat specifike sipas tipit të licencës (neni 9, pika 4/10, germa “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për mungesën e dokumentacionit që ka të bëjë me:

- Sasinë e energjisë elektrike të parashikuar për t’u tregtuar (neni 9, pika 4/10, germa “a”) dhe

- Kapitalin financiar të deklaruar nga shoqëria për ushtrimin e këtij aktiviteti, (neni 9, pika 4/10, germa “b”), do të njoftohet subjekti që në bazë të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, neni 10, pika 10 dhe neni 11, pika 1, t’i paraqesë këto në ERE brenda afateve të përcaktuara.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për licencimin shoqërisë “Lengarica & Energy” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit, e Monitorimit të Tregut dhe të të Licencuarve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI
Petrit Ahmeti**

VENDIM

Nr 86, datë 30.6.2015

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR
LICENCIMIN E SHOQËRISË
“LENGARICA & ENERGY” SHPK NË
AKTIVITETIN E FURNIZIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 2, germa “c”; 16; 37, pika 2, germa “ç” dhe 39, pika 3, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, neneve 4, pika 1, germa “f”; 5 pika 1, germa “f”; 10, pika 3, të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:



pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 108, datë 9.9.2008 dhe nenit 18, pika 1, germa “a” e “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 21 datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 30.6.2015, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Lengarica & Energy” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe të Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe të Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Lengarica & Energy” sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni juridik, administrator dhe pronësor (neni 9, pika 2) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për mungesën e dokumentacionit, që ka të bëjë me:

- Sasinë e energjisë elektrike të parashikuar për furnizimin e klientëve të kualifikuar (neni 9, pika 4/9, germa “a”);
- Nivelin e tensionit dhe mënyrën e realizimit të matjes për klientët e kualifikuar (neni 9, pika 4/9, germa “b”); dhe
- Kapitalin financiar të deklaruar nga shoqëria për ushtrimin e këtij aktiviteti (neni 9, pika 4/9, germa “c”) do të njoftohet subjekti që në bazë të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë /të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, neni 10, pika 10 dhe neni 11, pika 1, t’i paraqesë këto në ERE brenda afateve të përcaktuara.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë “Lengarica & Energy” sh.p.k., në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit, të Monitorimit të Tregut dhe të të Licencuarve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 87, datë 30.6.2015

PËR REFUZIMIN E KËRKESËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “PHOENIX PETROLEUM” SHA NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË GAZIT NATYROR

Në mbështetje të nenit 14, pika 1, germa “ç”, të ligjit nr. 9946, datë 30.06.2008, “Për Sektorin e Gazit Natyror”, si dhe neneve 4, pika 1, germa “ç”; 11 dhe 12, të “Rregullave dhe procedurave për licencimin, ndryshimin, transferimin e pjesshëm ose të plotë, heqjen dhe rinovimin e licencave në sektorin e gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 9, datë 11.2.2011, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 30.6.2015, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Phoenix Petroleum” sh.a., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe të Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe të Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e tregtimit të gazit natyror të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Phoenix Petroleum” sh.a., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, ndryshimit, transferimit të pjesshëm ose të plotë, heqjen dhe rinovimin e licencave në sektorin e gazit natyror”, si më poshtë:

- Nga dokumentacioni ligjor, administrativ dhe pronësor mungojnë:
- Dokumentacioni që tregon titujt e pronësisë mbi tubacionet e transmetimit të gazit në referim të nenit 9; pika 1, germa “d”/“v”.
- Dokumentacioni për lejet dhe autorizimet mjedisore në referim të nenit 9, pika 1, germa “d”/“vi”.
- Nga dokumentacioni për garancitë financiare dhe fiskale mungojnë:



- Deklarata e lëshuar nga sigurimet shoqërore dhe tatim-taksat në referim të nenit 9, pika 1, germa “e”/“i”;

- Garancia e përshtatshme financiare dhe garancia e performancës në referim të nenit 9, pika 1, germa “e”/“iii”;

- Certifikata e sigurimit nga një shoqëri sigurimesh, për jo më pak se 10 milionë USD, në referim të nenit 9, pika 1, germa “e”/“iv”;

- Vërtetimi i kryerjes së pagesës së aplikimit në ERE, në referim të nenit 9, pika 1, germa “e”/“v”.

- Nga dokumentacioni për të dhënat specifike sipas tipit të licencës mungojnë:

- Sasia mesatare e gazit natyror të shprehur në milion m/3 e parashikuar për t’u livruar gjatë një viti, në referim të nenit 9, pika 2, germa “e”/“i”.

- Garancia që cilësia e furnizimit me gaz përmbush kriteret minimale të operatorit të sistemit, në referim të nenit 9, pika 2, germa “e”/“ii”.

- Kapitali financiar dhe mbështetja financiare e nevojshme për kryerjen e aktivitetit, në referim të Nenit 9, pika 2, germa “e”/“iii”.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të refuzojë kërkesën për licencimin e shoqërisë “Phoenix Petroleum” sh.a., në aktivitetin e tregtimit të gazit natyror me shumicë.

2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrir Ahmeti

VENDIM

Nr. 88, datë 30.6.2015

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR MIRATIMIN E NJË NDRYSHIMI NË RREGULLAT E TREGUT SHQIPTAR TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 98, pika 2, të ligjit nr. 43/2015, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, nenit 26 të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin të Bordit të ERE-s nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 30.6.2015, pasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Drejtorisë së Licencimit dhe të Monitorimit të Tregut, në lidhje me një ndryshim në “Rregullat e tregut të energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 68, datë 23.6.2008, të ndryshuar,

VENDOSI:

1. Pika 1 e vendimit nr. 39, datë 18.3.2015, të Bordit të ERE-s, ndryshohet si më poshtë:

“Vendimi nr. 93, datë 16.7.2012, do t’i shtrijë efektet deri në datën 30.9.2015.”.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë shoqërinë OST sh.a., për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrir Ahmeti

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2015

Adresa
Bulevardi “Gjergj Fishta”,
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”,
Tel: 042427005, 04 2427006

Çmimi 308 lekë